

Shtojca 3 - Ecuritë dhe treguesit e monitorimit.

Ky kapitull, përmban një lloj udhëzuesi mbi monitorimin, në mënyrë që Harta Zonale e Komunës të Rahovecit të jetë i zbatueshëm si në aspektin kuantitativ po ashtu edhe në aspektin kualitativ. Bazuar në përvojat e kaluara ekziston nevoja për zhvillimin të një sistemi qëndrueshëm për zbatim të dokumenteve të planifikimit, dhe për mbështetje të gjerë për këtë synim. Komuna e Rahovecit është e bindur se përpos një planifikim i qëndrueshëm dhe hartimi të dokumenteve cilësore, po aq është i rëndësishëm është edhe aplikimi i tij në praktikë dhe në këtë drejtim ligji i ri i planifikimit ka vendosur theksin në përkrahjen më të madhe që komuna, institucionet dhe sektorët e tjerë kompetentë duhet bëjnë për gjetjen e rrugëve adekuate për zbatim e kësaj Harte Zonale . Përmes këtij udhërrëfyese, synohet të përshkruhen detyrat dhe kompetencat, strukturat dhe kapacitetet administrative në nivel lokal (komunë), e veçanërisht strukturat e tyre përgjegjëse për zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e masave, zhvillimeve dhe projekteve që rezultojnë nga HZK.

Komuna e Rahovecit e konsideron këtë kapitull si një përpjekje për të ndërtuar një sistem dhe koncept të zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të Harte Zonale në praktikën e përditshme dhe në procesin e planifikimit hapësinor. Zbatimi i qëndrueshëm i këtij dokumenti të planifikimit, kërkon qasje të ndryshme, varësisht nga aktet që përfshihen në zhvillimet, aktivitetet ose edhe në projektet e kësaj Harte Zonale , varësisht nga prioritetit dhe fazat e përfshirjes, nga mundësitë investive, konteksti politik, apo edhe rrethanat e veçanta në komunë ose qytet. Varësisht nga krijimi i rrethanave apo mundësive për qasje në kapacitete të tjera investive të sektorit privat, por edhe në fonde shtesë (donacione, huamarrje) që paraqesin edhe njërin ndër faktorët thelbësor për zbatimin e këtij dokumenti. Ky udhërrëfyese, po ashtu, ka edhe për qëllim që të kontribuojë sa më shumë në orientimin dhe profesionalizimin jo vetëm të administratës dhe autoriteteve lokale por dhe të aktorëve të tjerë të përfshirë në këtë proces. Do të përshkruhen në mënyrë të thjeshtë, të përmbledhur dhe të saktë të gjithë hapat që duhen ndjekur për të zbatuar HZK-në, dhe njëkohësisht të informojë lidhur me gjithë informacionin e nevojshëm që i duhet çdo pale të interesuar për të marrë pjesë në zbatimin e HZK-së.

Të gjithë aktet relevant të cilët duhet, dhe do ta përdorin këtë kapitull janë në fakt aktorët që merren me menaxhimin, zbatimin, koordinimin, dhe monitorimin e Hartës Zonale . Pjesa ekzekutive e Komunës siç janë Drejtoritë Komunale, janë faktorët relevantë në zbatimin dhe monitorimin Hartës Zonale dhe në këtë drejtim, ato duhet të jenë të pajisura me të gjithë mekanizmat dhe me mjetet e nevojshme, duke filluar nga posedimi i kopjeve të shtypura ose digjitale të Hartës Zonale . Përmes stafit të secilës drejtori, duhet të dihen përmbytjet, detyrat, si dhe obligimet që dalin nga plani. Drejtoritë, duhet të komunikojnë dhe t'i koordinojnë veprimet për zhvillimet, projektet dhe aktivitetet që janë rezultat i Hartës Zonale , por ato duhet të jenë edhe të informuara për zhvillimet e tjera që janë specifike brenda drejtorive, si dhe duhet ditur kufizimet dhe mundësitë ligjore nga fushat e tyre kompetente që i prekin ato, ashtu si edhe për zhvillimet, aktivitetet dhe projektet e tjera.

Në këtë kontekst për shembull, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, paraqesin drejtoritë komunale të cilat duhet të jenë të informuar për zhvillimet e parapara me këtë plan, sidomos duhet të jetë e informuar me planin e veprimit ku paraqiten edhe projektet, zhvillimet dhe masat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjate dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) duke avancuar çdo vit avancuar realizimin e sa ma shumë projekteve, zhvillimeve dhe masave të planifikuara që do mundësonin zbatimin e Hartës Zonale . Nga fusha e bashkëpunimit dhe e bashkëveprimit në mes të të gjitha drejtorive, njëjtë si Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave edhe të gjitha drejtoritë tjera kanë rol të madh në zbatimin e kësaj Harte Zonale , duhet theksuar se një rol strategjik që luajnë inspektorët e fushave të ndryshme të nivelit komunal të cilët, mbikëqyrin zbatimin dhe realizimin e aspektit përmbytësor dhe ligjor të Hartës Zonale . Duke e njohur rolin dhe fuqinë e sektorit privat, Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Pronë

Planifikimit, Ekipi Komunal për Zbatim, Monitorim dhe Vlerësim dhe instancat e tjera të nivelit komunal dhe qendror, në funksion të zbatimit të Hartës Zonale duhet t'i ofrojnë kushte dhe lehtësira për thithje të investimeve, dhe këtë sektor ta orientojnë në zhvillime të planifikuara dhe të qëndrueshme.

Krijimi i sistemit të përbashkët të GIS-it, shihet si domosdoshmëri dhe mundësi shumë e madhe e informimit dhe e komunikimit të shpejtë dhe të saktë në mes të drejtorive. Por, deri sa të krijohet ky sistem, drejtoritë duhet t'i shfrytëzojnë mjetet më pak të sofistikuara ose, ato mjete që i kanë në dispozicion. Një faktor me rëndësi, është Ekipi Komunal për Zbatim, Monitorim dhe Vlerësim si dhe për Analiza, Koordinim të Aktiviteteve por, edhe për të ndihmuar në zbatimin e tyre. Nëse komuna do ta ketë Zyrën për Projektim ose do të vazhdoj të kontrakttoj kompani për hartimin e projekteve për komunën, është e rëndësishme në funksion të zbatimit të planeve projektet që përgatiten të jenë nga Harta Zonale e Komunës.

Përfaqësuesit e Shoqërisë Civile, por edhe përfaqësues të tjerë të Lagjeve dhe të Vendbanimeve, janë po aq të rëndësishëm: sa në hartimin e Hartës Zonale, po aq edhe në zbatimin e tij. Prandaj, duhet fuqizuar bashkëpunimin me ta, sikurse edhe me sektorin privat dhe duhet krijuar një traditë të informimit, të komunikimit dhe të bashkëpunimit cilësor, dhe gjithsesi duhet shfrytëzuar të gjitha mjetet në këtë drejtim. Shpeshherë, përfaqësuesit e OJQ-ve, janë bartës të projekteve të ndryshme. Po ashtu, edhe mediat janë një faktorë që, jo vetëm ndikojnë në bartjen në publik dhe opinion të kuantitetit dhe kualitetit të Hartës Zonale, por ato luajnë një rol të rëndësishëm në bartjen e mesazhit tek qytetarët për rëndësinë e Hartës Zonale, për cilësinë dhe për transparencën në zbatimin e Hartës Zonale.

Siç theksuam më lartë, këta janë disa nga faktorët kryesor të cilët lidhen direkt me zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e realizimit të Hartës Zonale e Komunës. Mirëpo janë të pashmangshëm edhe faktorët e tjerë institucional, siç janë ministritë e ndryshme: Ministria e Pushtetit Lokal, Ministria e Planifikimit Hapësinor, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Brendshme, etj.

Për secilën nga këta aktorë, janë radhitur: Vizioni, objektivat, prioritetet strategjike, projekte prioritare, masat dhe mënyrat e zbatimit që do të përmbushen nga aktorët që janë kompetent për zbatimin e Hartës Zonale, dhe që do të përfitojnë prej tyre. Zbatimi i qëndrueshëm i Hartës Zonale, do ndjekë vijën e hartimit të Hartës Zonale sipas fushave të përfshira gjatë procesit të hartimit, këto fusha janë konsideruar si bazë në aspektin e masave, zhvillimeve dhe projekteve të cilat, janë pjesë e Hartës Zonale.

Për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së duhet themeluar EZMVP (Ekipi për Zbatim, Monitorim dhe Vlerësim të Hartës Zonale), por edhe koordinim të institucioneve dhe të partnerëve të tjerë, dhe intervenimeve që duhet ndërmarrë për zbatim të Hartës Zonale në nivelin komunal. Ky ekip do ketë në përshkrim të punës që nga identifikimi i masave, zhvillimeve, projekteve të parapara me plan, e deri te aspekti legal, si dhe do të kujdeset për vendosjen e projekteve e zhvillimeve dhe e masave në kalendarin buxhetor të komunës, dhe të institucioneve të tjera përgjegjëse.

Shkalla e përfshirjes së akterëve, zgjerohet prej institucioneve publike në nivelin komunal, tek shoqëria civile, tek sektori privat, tek institucionet tjera të nivelit komunal dhe qendror, si dhe tek partnerët dhe donatorët e mundshëm. Çdo institucion kompetent për zbatimin e Hartës Zonale, duhet të fokusohet edhe në rëndësinë e informimit adekuat, në kyçjen e të gjithë akterëve për zbatim, në përgatitjen e Hartës Zonale për zbatimin, në trajtimin e buxhetit për zbatim dhe të mekanizmave të nevojshëm, deri te monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të dokumentit.

Monitorimi dhe zbatimi i HZK-së së Rahovecit do fokusohet në tregues dhe veprime që avancojnë cilësinë, sasinë e zbatimit të Hartës Zonale, apo edhe që të dyja bashkë, treguesit do shërbejnë edhe për vlerësim të gjendjes në kuptimin e shkallës së zbatimit dhe pas çdo viti të avancohet zbatimi i dokumentit duke përfutur nga përvoja paraprake. Dispozitat për Zbatim udhëheqin përpjekjen për arritjen e qëllimeve dhe objektivave të Hartës Zonale e Komunës e cilat do monitorohen përmes shkallës së realizimit të projekteve, masave dhe zhvillimeve të planifikuara me tregues të matshëm, duke e kuptuar zbatimin e Hartës Zonale e Komunës si transformim me kujdes të vizionit, qëllimeve, objektivave dhe prioritetëve strategjike në rezultate të dukshme dhe të prekshme.

Ky dokument synon ta aktualizoj rolin e informimit dhe të komunikimit në zbatim të dokumenteve të planifikimit, si dhe të informojë për mundësitë dhe obligimet që ka komuna në ndërtimin dhe konsolidimin e marrëdhënieve të pushtetit me publikun (komunitetin), në këtë drejtim autoriteti

përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor do të siguroi që raporti i miratuar vjetor ndërsektorial për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së do të publikohet në faqen e internetit të komunës dhe ofrohet në kopje të letrës sipas kërkesës nga cili do akter. Komuna e Rahovecit ka përgjegjësi si ndaj banorëve të Rahovecit po ashtu edhe ndaj institucioneve qendrore përkatëse, lidhur me informimin dhe raportimin për punën e tyre që nënkupton, edhe zhvillimin e masave dhe të projekteve të planifikuara, si dhe procesin e zbatimit të tyre. Informimi dhe komunikimi, duhet të organizohet si segment brenda strukturave komunale dhe si i jashtëm, e që nënkupton informimin dhe komunikimin përtej strukturave komunale: me sektorin privat, shoqërinë civile, nivelin qendror dhe akterët e tjerë. Kjo pjesë e HZK-së ka si qëllim edhe që të kontribuojë sa më shumë në orientimin dhe profesionalizimin jo vetëm të administratës dhe autoriteteve lokale por, dhe të aktorëve të tjerë të përfshirë në këtë proces. Në këtë pjesë gjithashtu synohet që në mënyrë të thjeshtë, të përmbledhur dhe të saktë të përshkruhen të gjithë hapat që duhen ndjekur për të zbatuar HZK-në, dhe njëkohësisht të informojë lidhur me të gjithë informacionin e nevojshëm që i duhet çdo pale të interesuar për të marrë pjesë në zbatimin e HZK-së.

Të gjithë akterët relevant të cilët duhet dhe do ta zbatojnë HZK-në, janë në fakt akterët që merren me menaxhimin, zbatimin, koordinimin, dhe monitorimin e planeve. Kjo pjesë do trajtojë situatën aktuale dhe të planifikuar me HZK-ë. Roli i këtyre akterëve të lartpërmendur, është specifik dhe i drejtpërdrejtë sepse të gjithë këta akterë, dhe sidomos akterët komunal (duke qenë se këta janë zbatues në terren të planeve), janë pjesë jo vetëm e zbatimit të planeve, por edhe e monitorimit dhe e vlerësimit të planeve. Përmes kësaj pjese, mundësohet informacion i specifikuar sa i përket profilit të gjendjes, analizës së gjendjes, projekteve prioritare dhe përmbajtjeve të tjera të rëndësishme për zbatimin e këtyre planeve. Informimi dhe komunikimi, mundëson njohjen e publikut dhe të qytetarëve me zhvillimin e planeve, me zbatimin e tyre. Sipas një transparence të duhur, të hapur, konkrete, me fakte, etj. Akterët relevant dhe jo relevant, opinionin, mediat, etj, kanë mundësi që të kenë njohuri dhe qasje lidhur me zbatimin e Hartës Zonale, dhe komuna ngritë nivelin e transparencës dhe ulë nivelin e mundësisë që të abuzohet me planin, shifrat, cilësinë dhe me koston e tyre etj.

- Informimi dhe Komunikimi

Duke qenë aktiv në komunikimin e saj, komuna e Rahovecit dhe akterët e tjerë relevantë, duhet të kontribuojnë ndjeshëm në krijimin e kushteve për përkrahje në zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e Hartës Zonale. Fusha e informimit dhe e komunikimit në funksion të zbatimit të Hartës Zonale, ka nevojë për mbështetje të madhe të drejtuesve të institucioneve, dhe të vet institucioneve komunale.

Ndërtimi i marrëdhënieve të mira me publikun, do të ndikonte drejtpërdrejt në përmirësimin e praktikave të zbatimit të planeve, në përmirësimin e mbledhjes dhe përdorimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, në përdorimin efektiv të aseteve të komunës, në krijimin e një klime miqësore me bizneset, në inkurajimin e shoqërisë civile dhe të sektorit privat etj. Nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm të buxhetimit me pjesëmarrje, do të inkurajohen qytetarët në përfshirjen e tyre në zbatimin e prioriteteve të dala nga plani, në vlerësimin e nivelit të shërbimeve publike dhe në rritjen e transparencës në përdorimin e fondeve publike. Komuna është e detyruar të zbatoj kuadrin ligjor në lidhje me transparencën dhe informimin e publikut, në lidhje me tërë veprimtarinë ekonomiko-financiare të komunës dhe në këtë funksion, plani i informimit dhe i komunikimit do të përmbushte edhe këtë kërkesë, nga kuadri ligjor.

Në vijim, Komuna duhet të respektojë me rigorozitet procedurat ligjore të transparencës edhe gjatë zbatimit të Hartës Zonale komunal. Planin i informimit dhe i komunikimit, është baza mbi të cilën duhet të zhvillohet procesi i zbatimit transparent të Hartës Zonale, dhe i sigurimit të përkrahjes së gjerë nga të gjithë akterët në proces të zbatimit. Në këtë drejtim, komuna duhet t'i shfrytëzoj të gjitha mjetet e informimit dhe të komunikimit, për qasje sa më të gjerë dhe të qëndrueshëm në institucione dhe dokumente, aty ku ligjërisht është e mundur për publikun dhe akterët e tjerë relevant. Në këtë drejtim në funksion të zbatimit të dokumentit rekomandohet: Të ketë komunikim dhe motivim lidhur me strategjinë dhe planin e informimit dhe komunikimit me të

gjithë akterët,duhet mbahet plani në fokus të të gjithëve, botojeni atë dhe bëjeni le të shihet në gazeta, Postoni atë në Ueb faqen tuaj të Internetit dhe, Referojuni sa më shpesh që të jetë e mundur në mënyra të ndryshme dokumenteve të planifikimit. Këto udhëzime, do të ju ndihmojë për të ndërtuar dhe fuqizuar dinamikën e zbatimit të Hartës Zonale.

Një udhëzim tjetër i dobishëm në këtë drejtim, është një “Memo vjetore”, dërguar nga Kryetari i Komunës të gjithë liderëve të vendbanimeve, shoqatave jo qeveritare, bizneseve, qeverisë qendrore, institucioneve publike etj. Si shumë me interes për zbatim të Hartës Zonale konsiderohet analiza, informimi dhe komunikimi adekuat, cilësor etj., me të gjithë akterët dhe veçanërisht, me ata që ndihmuan në hartimin e Hartës Zonale. Njerëzit të cilët kanë ndihmuar me inpute, duhet mbajtur të përfshirë në vazhdimësi, përmes fuqizimit të informimit dhe të komunikimit, si një komponentë e rëndësishme dhe strategjike e zbatimit.

- Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi në funksion të zbatimit të planeve

Përkundër që në komuna e Rahovecit mund të thuhet lirisht se kishte një proces cilësorë gjatë përgatitjes së HZK-së në kuptimin e gjithëpërfshirës edhe të zbatimit të ligjit në fuqi, për kundër që bashkëpunimi dhe bashkëveprimi në mes të drejtorive gjatë hartimit të dokumentit ishte i mirë por, vlerësohet se ende ka mjaft shumë hapësirë për informim, bashkëpunim dhe bashkëveprim në mes të drejtorive, sidomos sa i përket zbatimit të Hartës Zonale. Në këtë drejtim, çdo drejtori duhet të jetë e përgatitur që të jetë në funksion të zbatimit të dokumenteve dhe në këtë drejtim, duhet të jetë e pajisur me të gjithë mekanizmat dhe mjetet e nevojshme duke filluar: nga posedimi i kopjeve të shtypur ose digjitale të Hartës Zonale, dhe stafi i secilës drejtori duhet të informohet me përmbajtjen, detyrat, si dhe me obligimet që dalin nga plani. Drejtoritë, duhet të komunikojnë dhe t'i koordinojnë veprimet për zhvillimet, projektet dhe aktivitetet që janë rezultat i Hartës Zonale, por edhe të jenë të informuara për zhvillimet tjera që janë të veçanta brenda drejtorive, si dhe duhet komunikuar edhe për kufizimet dhe mundësitë ligjore nga fushat e tyre kompetente që prekin drejtoritë por, edhe zhvillimet, aktivitetet dhe projektet e tjera.

Vlerësohet shumë i rëndësishëm krijimi i një sistemi digjital, i cili do të mundësojë komunikimin adekuat, azhurnimin e shpejtë dhe cilësor, transparencën në mes të drejtorive, por edhe transparencën ndaj akterve të tjerë. Një sistem i tillë, e ngritë shkallën e zbatimit (implementimit) të Hartës Zonale, dhe mundëson informim dhe koordinimin efikas, cilësorë, dhe në masë të madhe e ngritë edhe shkallën e zbatimit të detyrave, si dhe përgjegjësinë dhe transparencën ndaj të gjithë akterëve relevant. Krijimi i sistemit të përbashkët të GIS-it, shihet si domosdoshmëri nga që është edhe mundësi shumë më e madhe e informimit dhe e komunikimit të shpejtë dhe të saktë në mes të drejtorive. Por, deri sa të krijohet ky sistem, drejtoritë duhet t'i shfrytëzojnë mjetet më pak të sofistikuara ose, ato mjete që i kanë në dispozicion.

Drejtoritë komunale, gjithsesi duhet të vazhdojnë të i shkëmbejnë informatat, të bashkëpunojnë dhe të bashkëveprojnë në mënyrë cilësore mes tyre për zbatim të dokumentit. Zbatimi i Hartës Zonale, i aktiviteteve dhe i zhvillimeve të tjera fillon menjëherë pasi që ato të jenë aprovuar nga Kuvendi Komunal, mirëpo për lehtësimin e zbatimit të Hartës Zonale e Komunës vlerësohet hartimi i planeve të punës për çdo drejtori dhe zbatimi i tyre sipas sektorëve përkatës,bazuar edhe në plane të lartpërmendura. Këto plane sektoriale, do të prezantohen para Ekipit Komunal për Zbatim, Monitorim dhe Vlerësim për tu analizuar, për koordinim të aktiviteteve por edhe për të ndihmuar në zbatimin e tyre. Nga fusha e bashkëpunimit dhe e bashkëveprimit në mes të të gjitha drejtorive, duhet theksuar se një rol të madh dhe strategjik ka Drejtoria e Inspektionit, ose inspektorët e fushave të ndryshme të nivelit komunal.

Zbatimi i dokumentit është i lidhur ngushtë edhe me punën inspektorëve të fushave përkatëse. Vlerësohet mjaftë i rëndësishëm dhe duhet bashkëpunuar ngushtë për t'i informuar ata me zhvillimet e planifikuara, si dhe për t'i pajisur me harta (të shtypura me përpjesë të duhur ose digjitale) adekuate për këto zhvillime, dhe për kufijtë ndërtimor në veçanti, por edhe për zhvillime të tjera. Kjo bëhet pastaj, edhe për ta funksionalizuar bashkëpunimin dhe bashkëveprimin në mes të drejtorive në funksion të zbatimit sa më efikas dhe cilësor të Hartës Zonale.

Vlen të theksohet se rolin kryesor në fushën e bashkëpunimit me inspektoratin ose edhe me inspektorët, e mbanë Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Pronë por, në funksion të zbatimit të Hartës Zonale një rol të rëndësishëm e ka edhe Ekipi Komunal për Zbatim, Monitorim dhe Vlerësim, si dhe instancat e tjera të nivelit komunal dhe qendror.

Drejtorja për Ekonomi dhe Financa duhet të jenë të informuar për zhvillimet e parapara me plan, sidomos duhet të jenë të informuara me projektet dhe me masat konkrete nga plani si dhe për prioritetet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjatë. Duhet që sa më shumë projekte, zhvillime të parapara me plan të futen në rishikim të buxhetit gjatë gjysmës së dytë të këtij viti (2017), dhe planet të jenë bazë edhe për parashikimet buxhetore të trevjeçarit të ardhshëm që njihet si KAB Korniza Afatmesme Buxhetore. Vetëm me futjen e këtyre zhvillimeve, masave dhe projekteve në kalendarët buxhetor dhe aprovimin e tyre në nivelin komunal dhe qendror, jemi një hap më përpara në zbatimin e tyre.

Çdo herë, bashkëpunimi mundë të jetë i mirëseardhur dhe në funksion edhe të rishikimit të prioriteteve dhe të planeve sektoriale, dhe se ky bashkëpunim mundë të shfrytëzohet për projekte të cilat me vlerën që kanë, mund të sigurojnë donator ose investitor edhe jashtë kalendarit buxhetor. Për këtë arsye, bashkëpunimi me këtë drejtori duhet të jetë cilësorë, dhe i vazhdueshëm. Vlen të theksohet se, rolin kryesor në fushën e bashkëpunimit me Drejtorinë për Ekonomi dhe Financa, e mbanë Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Pronë edhe se në funksion të zbatimit të Hartës Zonale ka rol edhe Ekipi Komunal për Zbatim, Monitorim dhe Vlerësim, si dhe instancat tjera të nivelit komunal dhe qendror.

Mund të konstatohet se në funksion të zbatimit të Hartës Zonale e Komunës në këtë rast por edhe çfarëdo plani tjetër bashkëpunimi dhe bashkëveprimi në mes të drejtorive gjatë zbatimit duhet avancohet edhe atë duke filluar nga Drejtoria për Administratë të Përgjithshme, Drejtoria e Arsimit Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, Drejtoria e Inspeksionit, Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Drejtoria për Infrastrukturë Lokale.

- Zyra e projektimit

Edhe se edhe Rahovec kishte themeluar Zyrën për Projektim, Edhe si zyre komunale për projektim por edhe si një kompani e angazhuar nga jashtë komunës është shumë e rëndësishme në funksion të zbatimit të Hartës Zonale dhe të bashkëpunimit kështu që, projektet që përgatiten nga këto zyre duhet të jenë të bazuara në Hartën Zonale e Komunës. Nëse në këto zyre, përgatitjet e projekteve bëhen në bashkëpunim me drejtoritë kompetente dhe të bazuara në planin e lartpërmendura. Mund të thuhet lirishtë se, është bërë edhe një hap i mirë në funksion të zbatimit të planeve.

- Sektori privat, Shoqëria Civile dhe përfaqësuesit e Lagjeve dhe të Vendbanimeve

Bashkëpunimi me sektorin privat, me shoqërinë civile dhe me përfaqësuesit e lagjeve dhe të vendbanimeve në komunë, është shumë i rëndësishëm si në të gjitha fazat e hartimit të dokumentit edhe në zbatimin e tij. Sektori privat është forca shtytëse kryesore e zhvillimeve, prandaj në funksion të zbatimit të Hartës Zonale me këtë sektor, duhet krijuar një traditë të informimit, të komunikimit dhe të bashkëpunimit cilësor, dhe duhet shfrytëzuar të gjitha mjetet në këtë drejtim. Ajo që është e planifikuar, duhet ofruar për zbatim këtij sektori dhe mënyra e ofrimit duhet jetë e qëndrueshme dhe transparente. Duke e njohur rolin dhe fuqinë e sektorit privat, Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Pronë, Ekipi Komunal për Zbatim, Monitorim dhe Vlerësim dhe instancat e tjera të nivelit komunal dhe qendror, në funksion të zbatimit të Hartës Zonale duhet t'i ofrojnë kushte dhe lehtësira për thithje të investimeve, dhe këtë sektor ta orientojnë në zhvillime të planifikuara dhe të qëndrueshme.

Përfaqësuesit e Shoqërisë Civile, por edhe përfaqësues të tjerë të Lagjeve dhe të Vendbanimeve, janë po aq të rëndësishëm: sa në hartimin e planeve, po aq edhe në zbatimin e tyre. Prandaj,

duhet fuqizuar bashkëpunimin me ta, sikurse edhe me sektorin privat dhe duhet krijuar një traditë të informimit, të komunikimit dhe të bashkëpunimit cilësor, dhe gjithsesi duhet shfrytëzuar të gjitha mjetet në këtë drejtim. Shpeshherë, përfaqësuesit e OJQ-ve, janë bartës të projekteve të ndryshme. Do të ishte mirë, që edhe ata të jenë në funksion të ngritjes së vetëdijes për zbatim të Hartës Zonale ose edhe të projekteve e të zhvillimeve që rrjedhin nga plani. Në këtë drejtim, informimi dhe komunikimi me ta, është i një rëndësie jetike. Bashkëpunimi, mundë të ngritët në atë nivel që, përfaqësues të shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e lagjeve e të vendbanimeve, të arrijnë që të marrin përgjegjësi për projekte, për masa dhe zhvillime, e deri te roli i kujdestarit për zhvillime të pa planifikuara dhe ilegale. Niveli më i lartë i bashkëpunimit në këtë drejtim, arrihet atëherë kur prioritetet që dalin nga planet, janë të përbashkëta.

Në zbatim të dokumenteve, disa zhvillime të caktuara bëhen çështje e gjykatave: prej atyre komunale, e deri te nivelet e më të larta gjyqësore. Vlerësohet si i domosdoshëm bashkëpunimi me gjykatat dhe krijimi i një vije komunikimi dhe bashkëpunimi cilësor me to, në funksion të marrjes së vendimeve adekuate dhe me peshë të duhur. Ky bashkëpunim, është shumë i rëndësishëm sepse, është në funksion adekuat të parandalimit dhe të amortizimit të zhvillimeve të pa planifikuara. Duke e ditur se gjykatat tona janë shumë të ngarkuara, lëndët që vijnë nga kjo fushë duhet parë dhe duhet trajtuar me prioritet sepse, pasi që të bëhet zhvillimi apo implementimi në këtë drejtim, edhe tentimi për revidim ose edhe sanksioni eventual është i pa vlerë, dhe jo efikas.

Nëse nuk krijohet një urë e bashkëpunimi efikas me gjykatat, lejohen apo stimulohen edhe më shumë zhvillimet e pa planifikuara, dhe jo legale. Duke njohur rolin dhe fuqinë e gjykatave, Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Pronë, e në funksion të zbatimit të Hartës Zonale edhe Ekipi Komunal për Zbatim, Monitorim dhe Vlerësim si dhe instancat e tjera të nivelit komunal dhe qendror, duhet ofruar kushte, duhet krijuar komunikimin dhe bashkëveprimin të duhur në mënyrë që aty ku është e domosdoshme (madje edhe duke bashkëpunuar edhe me mekanizma të tjerë, siç është policia), të pengohen ndërtimet e pa planifikuara dhe ilegale në funksion të zbatimit efikas dhe cilësorë të Hartës Zonale adekuat, dhe legal.

Bashkëpunimi me Byro Projektuese dhe me Institute adekuate si dhe me institucione që merren me projekte zhvillimore në mënyrë profesionale, është i rëndësishëm dhe në funksion të zbatimit të Hartës Zonale, e të informimit adekuat. Komunikimi dhe bashkëpunimi në këtë drejtim, është shumë i rëndësishëm. Nëse vendosen ura të bashkëpunimit dhe të komunikimit dhe ngritët niveli i bashkëpunimit në shkallë adekuate, këto institucione nuk do të hartojnë plane dhe projekte pa qenë të parapara me plan. Në të njëjtën kohë, këtyre institucioneve duhet bërë të kuptojnë se për veprime të jashtëligjshme, mundë edhe të dënohen madje, edhe t'u ndalohej veprimtaria. Paralajmërimi si dhe shqiptimi i sanksioneve, besojmë se kontribuon direkt në zbatim e mirëfilltë të Hartës Zonale. Në këtë drejtim, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedis por edhe Ekipi Komunal për Zbatim, Monitorim dhe Vlerësim si dhe instancat e tjera të nivelit komunal dhe qendror, duhet ta luajnë rolin e vetë të informimit, të komunikimit dhe të bashkëveprimit me këto institucione.

Pasi që planet janë multisektorale dhe kompetencat, përgjegjësitë dhe ndikimet janë të ndryshme (si për nga niveli, ashtu edhe për nga fushëveprimtaria), bashkëpunimi në mes të institucioneve të caktuara, është njëra ndër shtyllat tjera ku duhet mbështetur për zbatim të planeve. Në këtë drejtim, aktivitetet dhe masat për zbatim, do jenë një bazë e mirë për informim, për komunikim dhe për bashkëpunim dhe bashkëveprim drejt zbatimit të planeve. Dihet fare mirë se, çfarë roli ka MMPH-ja, MBPZHR-ja Ministria e infrastrukturës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit por edhe ministritë e tjera në zbatim dhe në përcjellje të zbatimit të planeve.

Është shumë i rëndësishëm bashkëpunimi në mes të niveleve të caktuara për zbatim të Hartës Zonale. Dihet se ministritë e ndryshme si për shembull MMPH-ja, mundet që edhe të lëshoj leje. Siç thuhet në ligjin për planifikim, autoritetet duhet t'i lëshojnë lejen secilit aplikues, derisa propozimi për ndërtim përputhet me dispozitat e ligjit të planifikimit, dhe me ligjet e tjera dhe planet zhvillimore komunale dhe hartat Zonale dhe dokumentet tjera të planifikimit., duke e ditur edhe kompetencat për ujin, për Tokën dhe për ajrin që i ka (në këtë rast) MMPH-ja, një fuqizim i bashkëpunimit do të ndihmonte shumë në zbatimin e dokumentit.

Qeveria e vendit, me propozim të MMPH-së ka nxjerr akt të veçantë me të cilin, e rregullon mbikëqyrjen, por edhe ndëshkimin dhe marrjen e masave të përcaktuara me ligj për planifikimit. Prandaj, mbikëqyrja e akteve të përgjithshme dhe veç e veç, e kushteve dhe e mënyrës së punës të personave të juridik dhe fizik dhe marrja e masave është e përcaktuar po me këtë ligj dhe nga ministria nëpërmjet inspektorëve urbanistikë. Në këtë drejtim, procesin e nxjerrjes së planeve dhe të akteve të tjera, zbatimin e tyre, si dhe aplikimin e procedurave i inspektor MMPH.

Bashkëpunimi, informimi dhe komunikimi është çelësi i zbatimit të Hartës Zonale. Një rol të rëndësishëm, e ka edhe MBPZHR, e cila është kompetente për zhvillime të qëndrueshme bujqësore por, edhe për zhvillime të pyjeve. Në këtë drejtim, edhe mbrojtja e tokës bujqësore, është fushë ku gërshetohen interesat e nivelit lokal dhe qendrorë. Në këtë drejtim, planet për zbatim do të jenë një bazë e mirë për informim, për komunikim dhe për bashkëpunim dhe bashkëveprim drejt zbatimit. Fuqizimi i lidhjeve me këtë ministri, është çelës i mbrojtjes së tokës bujqësore për çka është i themeluar edhe Inspekcioni i Bujqësisë i cili me anë të inspektorëve të tij kryen punë inspektuese në fushat e bujqësisë: në tokat bujqësore, në sferën e Pylltarisë dhe të Gjuetisë, të mbrojtjes së Bimëve, të Blegtorisë dhe të Peshkatarisë, si dhe të Veterinarisë dhe të sigurisë së Ushqimit. Edhe përmes kësaj ministrie si dhe përmes inspektoratit të saj, duhet fuqizuar informimin, komunikimin dhe bashkëpunimin dhe bashkëveprimin për mbrojtjen e tokës bujqësore, si dhe të fushave të tjera relevante dhe ky, do të konsiderohej si një hap i rëndësishëm drejt zbatimit të Hartës Zonale.

Pasi që planifikimi është multisektoral, gati të gjitha ministrinë dhe të gjitha agjencionet e tjera publike, kanë një fushveprimtari, kompetencë dhe ndikim që prekë edhe zbatimin e planeve. Vlerësohet se, një bashkëpunim cilësor duhet krijuar në funksion të zbatimit të Hartës Zonale edhe në mes të niveleve, dhe dihet mirë se zonat e veçanta arkeologjike, arkitektonike janë fusha për zhvillim të përbashkët, mbrojtje por edhe zbatim, njëjtë si edhe një pjesë e madhe e granteve që vijnë nga niveli qendror. Lirishtë, duhet theksuar se cilësia e këtij bashkëpunimi, konsiderohet si mjaft përmbajtjesore për zbatim të Hartës Zonale.

- Mbështetja administrative

Komunat, duhet të marrin parasysh një mbështetje cilësore administrative për zbatim të planeve, duke e synuar me çdo kusht lirin nga vonesat burokratike dhe duke reaguar me cilësi ndaj vështirësive ligjore, duke vendosur afate dhe orare të duhura etj. Parashikohet edhe shfrytëzimi i teknologjive, si dhe i aplikimeve online për zhvillime.

Informimi, komunikimi dhe bashkëpunimi për thjeshtim sa më të madh të procedurave administrative, ndikon dukshëm në zbatim të dokumentit. Në këtë drejtim aplikimi online, matja e kohës se për sa kohë pala e interesuar e merr përgjigjen, janë parametra shumë të rëndësishëm për zbatim por, edhe për transparencë në zbatim.

Identifikoni palët qysh herët, dhe i njoftoni ato në mënyrë direkte mbi ndryshimet.

- Zgjedhja e partnerëve

- Përfshini aktivisht njerëzit lokalë dhe do ta bëni zbatimin më të lehtë, dhe kjo ndihmon edhe në shmangien e indiferencës së publikut të pa përgjegjësish.
- Përfshirja e resurseve njerëzore, si: ndërtimin bashkëpunues, themelimin e intervenimeve vetanake dhe vullnetin e partnerëve dhe të grupeve bashkëpunuese për të ndihmuar.
- Përfshirja direkte e njerëzve lokalë dhe pajtimi i tyre mbi zbatimin e Hartës Zonale, do t'i ndihmojë ata të krijojnë hapësirën e tyre, dhe të afirmojnë identitetin e përbashkët.
- Inicioni një seri të veprimeve të sektorit privat, përfshirja e sektorit privat është thelbësore për mbështetjen e Hartës Zonale (duke përfshirë mbështetjen financiare).
- Inkurajoni partneritetet private/publike për të zbatuar politikat e qëndrueshme.
- Zgjidhni partnerët me planet më të qëndrueshme, dhe me kursimtare për t'i zbatuar.

- Koha për përgatitje, zbatim dhe financim të Hartës Zonale, është thelbësore për sukses.
- Zgjidhni apo këshilloni për zgjedhjen e hartuesve të projektit ideor dhe kryesor, arkitektët dhe ekspertët tjerë që janë qartësisht të përkushtuar për zhvillimin e qëndrueshëm.
- Përdorni kriteret e zhvillimit të qëndrueshëm në kontratat me sektorin privat.
- Sfidoni të gjitha palët e përfshira, por edhe publikun ku është e mundur për të gjetur zgjidhje kreative ndaj problemeve të zbatimit të zhvillimit të qëndrueshëm.

- Procesi nëpër të cilin duhet të kalojë HZK-ja e Rahovecit

Hapi 1

Sigurohemi për zhvillimet, masat dhe projektet e parapara në Hartën Zonale e Komunës.

Hapi i parë në procesin e zbatimit, është që t'i kthehemi prapë Hartës Zonale dhe të sigurohemi që çdo drejtori, e di se çfarë përmban Harta Zonale e Komunës. Shqyrtimi me kujdes i Hartës Zonale, në mënyrë që të nxirren në pah zhvillime, masa, projekte të Hartës Zonale që duhet integruar në planin për zbatim të drejtorisë, kryesisht në kornizën e zhvillimit hapësinor. Këtu trajtohen edhe elemente që mund të jenë, veçanërisht të vështira për zbatim. Këtu, shkëpusim edhe hartat sektoriale, dhe i fusim ato në hartat bazë të Hartës Zonale për zbatim nga drejtoria përkatëse. Drejtoritë komunale sektoriale si zbatuese dhe monitoruese të aktiviteteve sektoriale përkatëse të tyre duhet hartuar sipas Procesit të monitorimit dhe vlerësimit bazuar në Planin e Veprimit.

Në këtë fazë, drejtoritë duhet të jenë të përqendruara në kuptimin hapësinor dhe zhvillimor në përmbajtjet e Hartës Zonale të korniza e zhvillimit hapësinor por edhe fazat e tjera, kur flasim në dimensionin hapësinor e vejmë theksin në zhvillime, masa dhe projekte që kanë për determinues hapësirën si një zonë e përkufizuar e cila me plan mund të jetë trajtuar: si zonë e mbrojtur, zonë ndërtimore, zonë ekonomike, zonë arkeologjike, zonë të cilat janë përkufizuar dhe destinuar për ndonjë qëllim të caktuar ose zonë të cilat paraqesin hapësirën ku ndodhet një pasuri nëntokësore ose sipërfaqësore, deri te zonat të cilat janë të kufizuara për shkak të rrezikut që paraqesin, ose shkallës së erozionit dhe degradimit etj

Dhe kur flasim në dimensionin zhvillimor e vejmë theksin në zhvillime, masa dhe projekte që kanë për determinues karakterin zhvillimor e që me plane, mund të jenë trajtuar: si projekte ose aktivitete zhvillimore nga fusha Ekonomike, e Infrastrukturës teknike, Infrastruktura e transportit dhe transporti, Infrastruktura publike dhe sociale, Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezikshmëri, asetet e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike, Vendbanimet, Banimi, Vendbanimet Joformale dhe fusha e Shfrytëzimit të tokës. Kur flasim për dimensionin zhvillimor të Hartës Zonale, e vëmë theksin tek zhvillimi i aktivitetit, tek projekti si determinues kryesor i kalimit prej gjendje momentale në atë të planifikuar, qoftë me ndërtimin e një shkolle, spitali, rrugë, kanalizimi, ujësjellësi, rryllizimi, zhvillimi industrial, projekti për mbrojtje nga ndotja etj.

Hapi 2

Krijoni një vizion për zbatimin e Hartës Zonale nga drejtoria. Ky vizion, mund të jetë një seri e qëllimeve që duhen arritur hap pas hapi, ose një përmbledhje e zhvillimeve, e masave dhe e projekteve që duhet të përfundojë dhe atë, sipas afateve kohore. Këtu, mund edhe ta vlerësojmë ndonjë pjesë të Hartës Zonale që mund të jetë e vështirë apo me kosto të lartë dhe që do na merrte më shumë kohë.

Këtu bazohemi kryesisht qëllimet, objektivat por sidomos të "Plani i veprimit për zbatim" ku nëpërmes projekteve synojmë arritjen e objektivave dhe qëllimeve nëpër fusha tematike, duhet të jetë e sigurt për të gjithë në drejtori se, çfarë rezultati përfundimtar duhet të jetë dhe arsyeja se, pse kjo është e rëndësishme. Të krijohet një informatë e qartë e asaj që Harta zonale ka si qëllim ta përmbush.

I identifikojmë dhe i nënvizojmë të gjitha elementet dhe i fusim në planin për zbatim, dhe duhet të jetë e qartë dhe e sigurt se, çka është paraparë me plan, si dhe duhet mbajtur në mend ajo se

s'i duhet të fillojë së zbatuari Harta Zonale. Pastaj, trajtohen edhe ide alternative në rast se plani origjinal, ngecë së zbatuari në ndonjë segment të tij.

Hapi 3

Përcaktohen treguesit për zbatim, ata tregues të cilët do të jenë kuantitativ (numra,përqindje) dhe tregues kualitativ. Çdo drejtori në bazë të zhvillimeve, të masave ose të projekteve të parapara, i përcakton treguesit për zbatim.

Hapi 4

Diskutohet me anëtarët e Ekipit Komunal për Zbatim,Monitorim dhe Vlerësim për t'u analizuar dhe për t'u ndihmuar zbatimin i Hartës Zonale. Sigurohemi që ky ekip,i cili duhet të ketë mbështetje të fortë që të veprojnë, e kupton qartë qëllimin e Hartës Zonale të zbatimit të çdo drejtorie, dhe i ka të qartë hapat e përfshirë në zbatimin e tij. Sigurohemi që udhëheqësi i ekipit së bashku me ekipin,e koordinojnë dhe e harmonizojnë zhvillimin. Ekipi, mund të inkurajojë drejtoritë në zbatim, dhe përgjigjet në pyetjet dhe shqetësimet e prezantuara lidhur me zbatimin. Ekipi, mund t'i adresojë problemet më lartë - në kuptimin e niveleve, nëse ato shfaqen.

Hapi 5

Diskutohet me akterët në proces lidhur me zbatimin e dokumentit në aspektin financiar, shikohen se sa janë zhvillimet, masa apo projektet afatshkurtra,afatmesme apo afatgjata. Shikohen implikimet financiare dhe akterët për zbatim, dhe diskutohet me akterët gatishmëria për zbatim. Vlen të theksohet se, akterët mund të jenë publik ose privat. Qeveria komunale,qendrore mund të ketë edhe donacione ose investime,dhe pas diskutimeve dhe pajtimeve në parim, punohet në planin e rishikimit të buxhetit për gjashtë mujorin e dytë 2017, dhe për trevjeçarin 2018 – 2021. E gjithë puna, bëhet duke u bazuar në planet për zbatim nga drejtoria,dhe të cilat përcillen edhe në Bord të Drejtorëve. Mbështetje e fortë,mund të vijë edhe nga Ekipi Komunal për Zbatim,Monitorim dhe Vlerësim.

Hapi 6

Përcaktohet orari i takimeve për t'u diskutuar raportet e progresit. Drejtoritë, duhet të përcaktojnë një orar brenda tyre për të raportuar për listën e zhvillimeve, masave e projekteve, e qëllimeve apo e objektivave të parapara në planin e punës i cili, mund të jetë çdo gjashtë muaj ose një orar tjetër varësisht nga interesat e drejtorisë. Drejtoritë, duhet të caktojnë edhe një orar takimesh me Anëtarët e Ekipit Komunal për Zbatim, Monitorim dhe Vlerësim, të cilët duhet ta din se çfarë është arritur. Nëse zbatimin është arritur përpara afatit ose pas afatit, duhet vlerësuar rregullisht "orari aktual", për t'u diskutuar ndryshimet që duhen bërë.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor nëpër mes koordinatorit, bashkërendon orarin e takimeve si dhe aktivitetet e zbatimit dhe monitorimit të HZK-së.

Hapi 7

Raportimi nga Ekipi Komunal për Zbatim,Monitorim dhe Vlerësim duhet të jetë i atillë që do t'i mbajë drejtuesit e komunës të informuar për atë që po ndodh, dhe të sigurojë raportet e progresit në zbatimin e Hartës Zonale. Ky raportim, i informon ata në lidhje me ecurinë e zbatimit, dhe i bënë ata pjesë të procesit, dhe aty ku mund të hasen probleme. Ekipi, duhet të jetë në gjendje për t'i adresuar shqetësimet apo për të propozuar ndryshime të mundshme.

Drejtoritë sektoriale hartojnë dhe dorëzojnë raportet sektoriale vjetore bazuar në ligj dhe akte nënligjore për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së tek autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor e cila bëhet nëpërmjet një përgjegjësi nga drejtoria por për arsye praktike në funksion të rishikimit të buxhetit besohet së drejtoritë sektoriale duhet të hartojnë dhe dorëzojnë raportet sektoriale dy herë brenda vitit.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor (Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Pronë nëpërmes koordinatorit) harton dhe dorëzon raportin vjetor dhe atë gjysmë vjetor ndërsektorial për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së, për miratim tek Kuvendi i Komunës.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinorë (Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Pronë nëpërmes koordinatorit), dorëzon raportin e miratuar vjetor ndërsektorial për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së në Ministrinë e Mjedisit dhe planifikimit Hapësinorë.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor (Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Pronë nëpërmes koordinatorit) siguron se raporti i miratuar vjetor ndërsektorial për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së publikohet në faqen e internetit të komunës dhe ofrohet në kopje të letrës sipas kërkesës.

Një propozim formë e Planit të Punës për Zbatim të HZK-së :

Plan pune dhe plan për zbatim të dokumenteve të planifikimit

Plani duhet ta ketë, këtë përmbajtje:

Ky dokument, është një plan pune dhe plan për zbatimin e Hartës Zonale e Komunës. Ky plan pune do të përgatitet në nivel drejtorie dhe do kemi Plan pune afat mesëm që do të përputhet me KAB (Korniza Afatmesme Buxhetore), Ky Plan pune do të përfshij periudhën tre vjeçare dhe do të përfshij projektet, masat dhe zhvillimet e planifikuara që do të priorizohen për tre vitet e ardhshme, dhe do kemi Plan pune afat gjatë që do të përfshij komplet Kohen e planifikuara me HZK dhe do të përfshij të gjitha projektet, masat dhe zhvillimet e planifikuara, Me qëllim të sqarimit të formës së përgatitjes së tyre planeve kemi marr si shembull Drejtoria e Infrastrukturës më konkretisht kemi shkoqitur përmbajtjen sektoriale të infrastrukturës.

Korniza e zhvillimit hapësinor

Shkoqitje e fushës së infrastrukturës nga Korniza e Zhvillimit Hapësinorë, Aspekti tekstual dhe Hartat.

Komponentët fizike (përkufizimi i zonave të cilat, janë paraparë me masa mbrojtëse, rehabilituese ose zona të destinuara për zhvillim të infrastrukturës).

Komponentë zhvillimore (projektet dhe zhvillimet e caktuar).

STRATEGJITË PËR ZBATIM

Shkoqitje e fushës së infrastrukturës nga strategjitë për zbatim (projektet, masat dhe zhvillimet e parapara), priorizimi i tyre për tre vite dhe përfshirja në KAB ose prezantimi para donatorëve ose sektorëve tjerë për miratim.

Komponentat fizike (përkufizimi i zonave të cilat, janë paraparë me masa mbrojtëse, rehabilituese ose zona të destinuara për zhvillim të infrastrukturës).

Komponentat zhvillimore (projektet dhe zhvillimet e caktuara).

▪ Treguesit për zbatim

Projektet, masat dhe zhvillimet e planifikuara	Projektet, masat, zhvillimet e planifikuara dhe të përfshira në Kornizën Afatmesme buxhetore (KAB) dhe Buxhetin Vjetorë	Treguesit	Projektet, masat, zhvillimet e realizuar sipas Kornizës Afatmesme buxhetore (KAB)
Në këtë kolonë vendosen të gjitha Projektet, masat, zhvillimet e planifikuara që kanë të bëjnë me përmbajtjet e poshtë shënuara edhe përmbajtjet e të	Në këtë kolonë vendosen të gjitha Projektet, masat, zhvillimet e planifikuara dhe të përfshira në Kornizën Afatmesme buxhetore (KAB) ose Planin e punës për	Në këtë kolonë vendosen Treguesit për të gjitha Projektet, masat, zhvillimet e planifikuara, treguesit mund të jenë tregues që paraqesin	Në këtë kolonë vendosen të gjitha projektet, masat, zhvillimet e realizuar sipas Kornizës Afatmesme buxhetore (KAB) ose Planit të punës për zbatim dhe Treguesit për të gjitha Projektet,

njëjtës temë që mund të mos jenë të shënuara por të trajtuara me plane	zbatim në vitet 2014/2015/2016	gjendjen kualitative dhe kuantitative	masat,zhvillimet e realizuar
Infrastruktura	Rrugë lokale asfaltim (a-b)	Gjatësia (M) 1800 m	Gjatësia (M) 1600 m
	Kanalizim	Gjatësia (M) 4800 m	Gjatësia (M) 4700 m
	Deponi të përkohshme	Sasia me copë (2) Sipërfaqja me ari (44)	Sasia me cope (2) Sipërfaqja me ari (34)

INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI

Këtë në kuadër planit duhet të përshkruajmë të gjitha detyrat dhe veprimet që duhet ti ndërmarrim për informim dhe komunikim në funksion të zbatimit të kësaj Harte Zonale pune

BASHKËPUNIMI DHE BASHKËVEPRIMI NË FUNKSION TË ZBATIMIT TË PLANEVE

Këtë në kuadër planit duhet të përshkruajmë të gjitha detyrat dhe veprimet që duhet ti ndërmarrim për bashkëpunim në mes drejtorive, me akter tjerë dhe në mes të niveleve në funksion të zbatimit të kësaj Harte Zonale pune për shërbimet publike (Infrastrukturën).

PLANIFIKIMI BUXHETOR

Këtë në kuadër planit duhet të përshkruajmë të gjitha detyrat dhe veprimet që duhet ti ndërmarrim për të siguruar financat në kuadër të KAB-it, nga donator dhe investitor tjerë duke përfshirë edhe sektorin privat me theks të veçantë edhe duke trajtuar partneritete e mundshme në funksion të zbatimit të kësaj Harte Zonale pune për shërbimet publike (Infrastrukturën).

MBËSHTETJA ADMINISTRATIVE

Këtë në kuadër planit duhet të përshkruajmë të gjitha detyrat dhe veprimet që duhet ti ndërmerrë administrata në kuptimin e procedurave dhe kapaciteteve njerëzore e teknologjike në funksion të zbatimit të kësaj Harte Zonale pune për shërbimet publike (Infrastrukturën).

ZGJEDHJA E PARTNERËVE

Këtë në kuadër planit duhet të përshkruajmë të gjitha detyrat dhe veprimet që duhet ti ndërmerrë zyra e prokurimit dhe zyrtarët tjerë përgjegjës në kuptimin e procedurave,procesit të bazuar në kornizën ligjore,transparencë dhe kushte të njëjta për të gjithë të interesuarit në funksion të zbatimit të kësaj Harte Zonale pune për shërbimet publike (Infrastrukturën).

ZBATIMI I PLANEVE

Këtë në kuadër planit duhet të përshkruajmë të gjitha obligimet,detyrat dhe veprimet ligjore që duhet të ndërmerren në kuptimin e procedurave,procesit të bazuar në kornizën ligjore në funksion të zbatimit të kësaj Harte Zonale pune për shërbimet publike (Infrastrukturën).

- **Ekipi komunal për përkrahje në zbatim të dokumenteve, monitorim dhe vlerësim (EKPZDMV)dhe për formimin e ekipit**

Komuna e Rahovecit në funksion të zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të HZK-së ka përgatitur këtë propozim për (EKPZMV) që do shërbej edhe si një mekanizëm për monitorimin dhe vlerësimin e progresit të komunës drejt arritjes së të gjitha aspekteve të Hartës Zonale, në bazë të treguesve të matshëm.

Formimi i EKZMV-së

Për ofrim të përkrahjes në procesin e zbatimit të Hartës Zonale e Komunës, si dhe në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të kësaj Harte Zonale , duhet të formohet Ekipi Komunal për Përkrahje në Zbatim të Dokumenteve, Monitorim dhe Vlerësim (EKPZDMV). (në tekstin e mëtejshëm: Ekipi)

si organ koordinues për zbatim, monitorues dhe vlerësues i cili, funksionon në kuadër të qeverisë komunale dhe i raporton Bordit, Kryetarit dhe Kuvendit të Komunës.

Ekipi, themelohet nga Kryetari i Komunës, i cili, i propozon Kuvendit të Komunës emërimin e një ekipi për Monitorim dhe Raportim lidhur me zbatimin e Hartës Zonale për të udhëhequr dhe për të koordinuar punën në të gjitha drejtoritë. Përbërja e ekipit, duhet të përfaqësojë akterët kryesor në zbatimin e dokumenteve, dhe është kompetent për monitorim dhe raportim. Në rastin më të mirë, anëtarët e ekipit për monitorim dhe zbatim të Hartës Zonale mund të jenë shërbyesit civil që ishin të trajnuar nga Ministria e Administrimit Lokal për matjen e performancës së komunës.

Ekipi i emëruar nga Kuvendi i Komunës, duhet të jetë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të HZK-së (por mund të shërbejë edhe për planet tjera) dhe raportimin. Monitorimi, kryhet në intervale kohe të ndryshme: mujore, dy mujore por edhe tre mujore prej nga përgatitet një raport fillestar. Monitorimi, mund të kryhet në interval kohe prej gjashtë muajsh, dhe Ekipi është i obliguar që nga Drejtorive sektoriale të ju kërkojë të hartojnë dhe dorëzojnë raportet sektoriale vjetore për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së tek autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor nëpërmes anëtarëve të ekipit dhe më pastaj Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor harton dhe dorëzon raportin vjetor ndërsektorial për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së, për miratim tek Kuvendi i Komunës nëpërmes koordinatorit të Ekipit dhe i njëjti i dorëzon raportin e miratuar vjetor ndërsektorial për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së në Ministri dhe siguron se raporti i miratuar vjetor ndërsektorial për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së publikohet në faqen e internetit të komunës dhe ofrohet në kopje të letrës sipas kërkesës.

Monitorimi, mund të kryhet edhe në interval kohe prej disa vitesh radhazi. Pasi që ky plan është disa vjeçare, intervalet kohore përcjellin zhvillimet brenda drejtorive, por edhe asaj që është paraparë me plan të zbatimit. Raporti i monitorimi dhe zbatimit, përgatitet nga Ekipi për Monitorim dhe Raportim.

Ekipi i emëruar nga Kuvendi i Komunës dhe anëtarët nga të gjitha drejtoritë komunale, bashkëpunojnë në mënyrë që të organizojnë dhe funksionalizojnë Sistemin e Monitorimit dhe të Zbatimit të Hartës Zonale si dhe Raportimin. Ekipi, nëpërmjet Zyrës për Informim, informon edhe qytetarët 15 ditë para datës së raportimit në një tubim të qytetarëve për gjetjet në procesin e zbatimit të planeve, dhe në atë takim kërkon edhe propozimet e qytetarëve për masa, zhvillime dhe projekte që, do të mund të futeshin në rishikim të buxhetit dhe KAB, përmes:

- Shpalljeve publike të vendosura në objektet publike, dhe vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës,
- Mediave lokale,
- Ueb faqes zyrtare të Komunës.

Kryetari i Ekipit, bashkë me Ekipin ftojnë përfaqësuesit e Drejtorive, që të marrin pjesë në takime për t'u konsultuar dhe diskutuar lidhur me zbatimin e planeve, dhe përfaqësuesit e Drejtorive raportojnë për zhvillimet, por edhe propozojnë masat e aktiviteteve që i kontribuojnë zbatimit të planeve. Konsultime organizohen edhe me kryetar të Këshillave Lokale të Fshatrave, të Vendbanimeve, të Lagjeve Urbane dhe përfaqësues të Shoqërisë Civile që, të kontribuojnë me propozime, sugjerime dhe komente gjatë procesit të monitorimit të zbatimit të planeve për të gjitha fushat; Informojnë nëpërmes formave të ndryshme për zhvillimet ilegale në vendbanimet, lagjet urbane dhe përgatiten për projekt-propozimet; Masat dhe zhvillimet e parapara me plane në periudhën e dëgjimeve publike për buxhet; Tubimet e rregullta publike; Takimet për planifikim strategjik që organizohen nga Komuna, përkatësisht Kuvendi i Komunës ose Kryetari.

Së paku një anëtar i Këshillit Lokal të Fshatit, të Vendbanimit apo të Lagjes urbane duhet të jetë person kontaktues për Monitorimin e Zbatimit të Hartës Zonale në fshat, vendbanim apo lagje urbane. Ky person, mund të jetë personi i cili, me rregulloren për Këshilla të Fshatrave, është përfshirë në grupet punuese komunale për planifikim të Hartës Zonale të Komunës.

Kryetari i Komunës, duhet që (së paku) të organizojë dy takime në vit me Ekipin e Monitorimit dhe të Raportimit. Takimet, duhet të mbahen së paku një herë në gjashtë muaj, edhe pse

preferohet çdo tre muaj të ketë takime. Për rendin e ditës, duhet të konsultohen edhe nëse konsiderohet se raportimi për zhvillimet lidhur me zbatimin e planeve dhe përgatitja e raporteve gjashtëmujore dhe njëvjeçare, duhet të jetë pika kryesore. Kuvendi i Komunës, mund të kërkojë një opinion nga Ekipi për çështje të caktuara me interes për qytetarët, dhe institucionet.

Procesi i zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit mbështet në parimi e Ligjshmërisë sipas të cilit parim, Komunitat ushtrojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre brenda kushtetutës, ligjeve dhe akteve të tjera normative të Republikës së Kosovës. Zbatimi i këtij parimi, nënkupton edhe zbatimin e parimit të Transparencës, dhe në këtë mënyrë komunitat, promovojnë transparencën e organeve Legjislative, Ekzekutive dhe Administrative, duke e rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në zbatimin e planeve në nivel lokal, dhe duke lehtësuar qasjen publike në dokumentet zyrtare të komunitës.

Përbërja e ekipit

Ekipi, duhet të përbëhet prej Koordinatori, Zëvendës-koordinatori dhe prej nga një anëtarë e çdo drejtorie Komunale:

1. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.
2. Drejtoria për Ekonomi dhe Financa
3. Drejtoria për Urbanizëm dhe Mjedis (Koordinator)
4. Drejtoria e Infrastrukturës
5. Drejtoria për Ekonomi dhe Financa
6. Drejtoria e Arsimit
7. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
8. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
9. Drejtoria për Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër
10. Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (Zëvendës-koordinator)
11. Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë

Ekipin e udhëheqë dhe e kryeson koordinatori i ekipit, kurse në mungesë të tij, zëvendësi i koordinatorit të ekipit.

Përbërja e ekipit, duhet të reflektojë barazi gjinore dhe mundësi të barabarta për të gjithë.

Me propozim të Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës me vendim të veçantë, do të përcaktoj emrat e anëtarëve të ekipit.

Përbërja e ekipit sipas nevojës, mund të zgjerohet me ekspertë tjerë profesional, mirëpo numri i anëtarëve të rregullt, duhet të mbetet siç është paraparë nga një anëtarë për çdo drejtori komunale.

Anëtarë të ekipit, duhet të jenë zyrtarët nga drejtoritë komunale por të cilët, i kryejnë punët profesionale të planifikimit hapësinor, ose kanë qenë të kyçur apo edhe të informuar për procesin e përgatitjes së Hartës Zonale.

Koordinatori i ekipit, është mirë të jetë nga drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit dhe duhet jetë mirë i informuar për plane dhe teknologji informative.

Detyrat e ekipit

Ekipi ka për detyrë të:

- Kërkojë nga drejtoritë të përgatiten nga çdo drejtori të planeve të punës dhe planeve për zbatim të dokumenteve të planifikimit (Hartës Zonale e Komunës, Hartës Zonale Komunale dhe Planeve Rregulluese të Hollësishme), të cilat i nxjerr Kuvendi i Komunës.

- Jep mendime, propozime dhe vërejtje në planet e punës dhe planet për zbatim të dokumenteve të (Hartës Zonale e Komunës, Hartës Zonale Komunale dhe Planeve Rregulluese të Hollësishme) të cilat i nxjerr Kuvendi i Komunës.
- Të koordinoj procesin në hartimin e planeve të punës dhe planeve për zbatim të dokumenteve të planifikimit (Hartës Zonale e Komunës, Hartës Zonale Komunale dhe Planeve Rregulluese të Hollësishme), të cilat i nxjerr Kuvendi i Komunës.
- Të përcjellë dhe të kujdeset për procedurat nëpër të cilat, duhet të kalojnë dokumentet e planifikimit drejtë zbatimit.
- Të monitoroj zbatimin e dokumenteve të planifikimit (Hartës Zonale e Komunës, Hartës Zonale Komunale dhe Planeve Rregulluese të Hollësishme), të cilat i nxjerr Kuvendi i Komunës.
- Të vlerësoj zbatimin e dokumenteve të planifikimit (Hartës Zonale e Komunës, Hartës Zonale Komunale dhe Planeve Rregulluese të Hollësishme), të cilat i nxjerr Kuvendi i Komunës.
- Të koordinoj punën dhe informimin e komunikimin me akter të ndryshëm.
- Të kryej edhe punë të tjera të cilat janë në interes të zbatimit të planeve por edhe monitorimit dhe vlerësimit.
- Të bashkëpunon me Drejtorinë për Zhvillim ekonomik dhe Turizëm si dhe Drejtorinë e Financave por edhe me institucione dhe akter të tjerë në funksion të futjes së zhvillimeve, masave dhe projekteve në vijat buxhetore.
- Të i kërkoj Drejtorive sektoriale të hartojnë dhe dorëzojnë raportet sektoriale vjetore për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së tek autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor nëpërmes anëtarëve të ekipit
- Më pastaj të sigurohet që Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor harton dhe dorëzon raportin vjetor ndërsektorial për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së, për miratim tek Kuvendi i Komunës nëpërmes koordinatorit të Ekipit dhe i njëjti i dorëzon raportin e miratuar vjetor ndërsektorial për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së në Ministri dhe siguron se raporti i miratuar vjetor ndërsektorial për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së publikohet në faqen e internetit të komunës dhe ofrohet në kopje të letrës sipas kërkesës.
- Ekipi mban takimet e rregullta, duhet t'i raportoj në Bord të Drejtorëve edhe te Kryetari në baza tre mujore dhe para Kuvendit të Komunës për punën e vet dhe për zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e planeve një herë në vit por preferohet së paku dy herë.

Kompensimi për anëtarët e ekipit

Ekipi është organ koordinues për zbatim, monitorim dhe vlerësim i Qeverisë Komunale dhe paguhet nga pagat mujore, për pos nëse kërkohet punë shtesë dhe e veçantë atëherë duhet me një vendim të Kuvendit të Komunës të caktohet edhe kompensimi për punën e Ekipit.

Punët administrativo – teknike të ekipit

Për punët administrativo-teknike dhe çështje tjera lidhur me punën e Ekipit, është përgjegjës qeveria Komunale.

Ekipi në funksion të kryerjes së obligimeve të veta dhe përmbushjes së obligimeve ligjore, i përcakton rregullat e procedurës për punën e tij, formatin e raportimit dhe takimet me drejtorit dhe subjektet tjera të interesit.

Përcaktimi i treguesve

- Kombinoni kriteret për vlerësim me qëllimet e politikës dhe Hartës Zonale.
- Sigurohuni që ka një pajtim të përgjithshëm mbi treguesit para aplikimit të tyre.
- Miratoni treguesit që janë të qartë dhe të kontrollueshëm.
- Miratoni treguesit që janë të matshëm, të afërt dhe konsistentë.
- Miratoni treguesit që janë të rëndësishëm për kontekstin komunal.

- Miratoni treguesit që janë të ndjeshëm ndaj kushteve të ndryshueshme, dhe që mund të azhurnohen lehtë.
- Miratoni tregues që janë të krahasueshëm me programet apo planet tjera.
- Ndërlidheni monitorimin me ndikimin në mjedis dhe studimet e revidimit.
- Ndërlidheni monitorimin me auditimet tjera të aktiviteteve të qytetit, fondit të ndërtimeve, etj.
- Ndërlidhni problemet e zhvillimeve aktuale me sistemin e monitorimit që, të mund të zgjerohet apo ndryshohet edhe përdorimi i treguesve.

Rezultatet e komunikimit

- Organizoni takime të rregullta me të gjitha palët e përfshira që të mund të matni përparimin deri atëherë, të identifikoni detyrat e jashtëzakonshme, të identifikoni nevojën për veprime të ardhshme dhe të vlerësoni përputhshmërinë e resurseve që i janë përkushtuar aktivitetit/planit.
- Ndërlidhni rezultatet e analizave të zhvillimeve të monitoruara me vendimet që merren mbi zhvillimet e ardhshme.
- Bashkërendoni propozimet për ndryshimin e Hartës Zonale.

▪ Monitorimi dhe vlerësimi

Monitorimi, është një proces i vazhdueshëm i mbledhjes, analizës, krahasimit, korrigjimit dhe raportimit të informacionit për të përcaktuar nëse, është bërë progres në arritjen e vizionit, objektivave, zhvillimeve të parapara, projekteve, masave dhe aktiviteteve të planifikuara si dhe të evidentojë faktorë pozitiv dhe negativ të cilët, ndikojnë në zbatim të planeve.

Monitorimi është mënyra sistematike e mbledhjes dhe e analizës së të dhënave të grumbulluara nga drejtoritë komunale dhe burimet tjera/informacionit, në lidhje me zbatimin e planeve për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm të zbatimit. Është procesi nëpërmjet të cilit, zbatuesit e planeve sigurohen që zhvillimet, projektet, masat dhe aktivitetet që kryhen, janë në përputhje me ato të planifikuara në plane dhe brenda afateve të caktuara. Është një përpjekje sistematike për të krahasuar performancën/punën në zbatim të planeve me vizionin, objektivat, zhvillimet e parapara, projektet, masat, aktivitetet dhe standardet e caktuara për të përcaktuar nëse, po bëhet progres. Gjithashtu, parashikon dhe marrjen e masave korrigjuese ku ka devijime, parashikimin e vështirësive para se të shfaqen, dhe kryerjen e korrigjimeve të nevojshme për ta mbajtur planet brenda detyrimeve të tyre.

Monitorimi përbëhet prej procesit të vazhdueshëm të mbledhjes së të dhënave dhe matjes së progresit drejt arritjes së objektivave të vizionit, objektivave, zhvillimeve të parapara, projekteve, masave dhe aktiviteteve të planifikuara.

Monitorimi, vlerëson shkallën sipas të cilës planet: po zbatohen, në përputhje me hartimin dhe planit për zbatim të planeve ose edhe strategjive për zbatim të planeve. dhe sa po i adreson nevojat e grupit ose grupeve të synuar.

Komuna e Rahovecit në funksion të zbatimit të planeve, dhe përcjelljes sistematike të zbatimit të tyre, ka përgatitur këtë udhëzues për zbatim të planeve, dhe atyre që u dedikohet ky udhëzues janë të gjitha drejtoritë në nivel komunal, institucionet publike në nivel komunal dhe qendrorë përkatëse, të cilat kanë qenë pjesëmarrës në hartim, janë kompetente për fusha të caktuara që mbulohen me plane ose janë pjesëmarrës edhe në zbatim të planeve, plane që zbërthehen në zhvillime, masa, aktivitete e projekte.

Qëllimi kryesor i kësaj pjese të udhëzuesit si pjesë jo obligative e Hartës Zonale, është të ofroj njohuri dhe të zhvilloj kapacitete për monitorim /vlerësim në nivelin komunal dhe te institucionet e lartpërmendura për Hartën Zonale e Komunëse dhe avancohet edhe për planet tjera.

Këtu do trajtohen çështjet që lidhen me rëndësinë e funksionit monitorues që, duhet të përformojnë komuna dhe institucionet tjera, por edhe identifikimin e pengesave për të marrë këtë

funksion si p.sh., mungesën e financimeve për të zbatuar funksionin monitorues, mungesën e mekanizmeve institucionale për të marrë përsipër një funksion të tillë, boshllëkun që ekziston ndërmjet Planeve dhe Buxhetimit dhe mungesës së financimeve për të harmonizuar prioritetet e planeve me buxhete relevante, mungesën e sistemit të të dhënave nga komunat tek niveli qendror për implementimin e planeve (Zhvillimeve, masave, projekteve dhe aktiviteteve tjera të planifikuara).

Disa nga shfrytëzuesit e këtij udhëzuesi do të përfshihen në aktivitete për të hartuar plane monitoruese në nivel sektorial (drejtorie) por edhe në nivel Planit, dhe do sfidohen me vështirësitë në identifikimin e indikatorëve bazë për monitorim dhe indikatorëve të performancës veçanërisht në nivel zhvillimesh, projektesh, objektivash edhe rezultatesh. Ata, gjithashtu do të sfidohen në raportimin e procesit të hartimit të planit të monitorimit që, kërkon inpute nga aktorë të ndryshëm të cilët, duhet të angazhohen dhe konsultohen në fazën e dizenjimit për të caktuar indikatorët bazë dhe burimet e të dhënave.

Fillimisht duhet të thuhet se Monitorimi i HZK-së bëhet njëkohësisht me zbatimin e HZK-së.

Dispozitat për Zbatim përmbajnë një mekanizëm për monitorimin dhe vlerësimin e progresit të komunës drejt arritjes së të gjitha aspekteve të Hartës Zonale, në bazë të treguesve të matshëm

Monitorimi i Zbatimit të HZK-së bëhet sipas procesit të monitorimit dhe vlerësimit i përcaktuar në Planin e Veprimit nëpërmjet informatave të mëposhtme:

12. burimi/ burimet e të dhënave;
13. frekuenca e mbledhjes së të dhënave;
14. të dhënat bazë;
15. qëllimet dhe kornizat kohore për arritjen e qëllimeve;
16. institucioni/ institucionet përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave; dhe
17. sistemi i përdorur për menaxhim të të dhënave.

Qëllimi i monitorimit dhe i vlerësimit

- Rezultatet e planifikuara janë siguruar dhe arritur,
- Përmirësimi, menaxhimi dhe mbështetja,
- Gjenerimi i kuptimit të përbashkët,
- Gjenerimi i njohurive të reja dhe mbështetja e të mësuarit,
- Ndërtimi i kapaciteteve të atyre që janë përfshirë.
- Aktorët, motivimi,
- Sigurimi i përgjegjësisë,
- Nxitja mbështetjes publike dhe politike.

Projekti i monitorimit, ndihmon për të siguruar sugjerime konstruktive, si:

Shtyrjen e zhvillimeve, masave, aktiviteteve dhe projekteve edhe se Anulimi apo shtyrja e zbatimi të ndonjë aktiviteti të Planit të Veprimit të HZK-së bëhet vetëm me pëlqimin paraprak të Kuvendit të Komunës e që nënkupton monitorimi do të ndihmon komunës me informata për të marrë vendim për anulim ose shtyrje (nëse këto janë drejtuar pas orarit)

Nëse bëhet një vendim për shtyrjen apo anulimin e një aktiviteti, Planit i Veprimit do të përditësohet me vendimin e ri ashtu që të jemi azhur

Ribuxhetimi i zhvillimeve, masave, aktiviteteve dhe projekteve (përvetësimi i fondeve, shmangja e shpenzimeve të panevojshme).

Ricaktimi i stafit (zhvendosjen e stafit nga një zonë në tjetrin; rekrutimin e personelit të përkohshëm për të plotësuar orarin kohor).

Hapat të Monitorimit

- Identifikimi i treguesve (njësive) të ndryshme të përfshira në planifikimi dhe zbatim gjegjësisht edhe në planin për zbatim.
- Identifikimi i zhvillimeve, masave, aktiviteteve dhe projekteve mbi të cilat reagimi është i nevojshëm.
- Performanca e zhvillimit, raportimi.
- Përcaktimi periodik i raportimit.
- Precizimi i përgjegjëseve në nivele të ndryshme, raportimi.
- Përpunimin dhe analizimi i raporteve.
- Identifikimi i zonave kritike / pabesueshmëria në zbatim.
- Sigurimi i masave të nevojshme korigjuese.

Treguesit për Monitorimin

Zhvillimet, masat, aktivitetet dhe projektet janë të monitoruara zakonisht nëse:

- Janë duke u realizuar ose jo,
- Lëvizin me kohë,
- Lëvizin brenda shpenzimeve të planifikuara,
- Pranimi i shpenzimeve adekuate.

Metodat/teknikat e monitorimit

- Raportimi i projektit,
- Informatat e dorës së pare,
- Raportet formale,
- Statusi i zhvillimeve, masave, aktiviteteve dhe projekteve,
- Orari i grafikuar i zhvillimeve, masave, aktiviteteve dhe projekteve,
- Raporti i statusi financiar i zhvillimeve, masave, aktiviteteve dhe projekteve,
- Raportet informale,
- Prezantimet grafike.

▪ Planifikimi dhe Monitorimi

Planifikimi dhe monitorimi, janë pjesë e rëndësishme të një procesi dhe sipas shumë njohësve të kësaj fushe, konstatohet se planifikimi pa monitorim dhe anasjelltas, janë të pakuptimtë.

Planifikimi, është përcaktimi i Vizionit, qëllimeve, objektivave, zhvillimeve, projekteve, masave, aktiviteteve strategjive për zbatim duke përfshirë edhe afatet kohore.

Dhe dihet se Planifikimi, i paraprinë monitorimit.

Monitorimi, është përcjellja e zhvillimeve, drejtimit/orientimit të operacioneve/aktiviteteve të lidhura me progresin e zbatimit të planeve me respektimin e standardeve, zbatimin e korigjimeve dhe marrjen e feedbackut/ reagimeve/ komenteve.

Planifikimi dhe monitorimi, janë të ndërlidhur. Planifikimi, përcakton kursin e drejtimit dhe monitorimi siguron që jemi duke ndjekur kursin e përcaktuar.

Te planifikimi duhet të përgjigjemi në disa pyetje kryesore gjithëpërfshirëse, siç vijon:

- Ku jemi tani?
- Ku duam të arrijmë?
- Si të arrijmë atje?

Në mënyrë që mundësohen synimet e sipërpërmendura, duhet që të adresohen pyetjet vijuese:

- Cili është Vizioni dhe cilat janë qëllimet dhe objektivat ?
- Çfarë zhvillimesh janë planifikuar në cilën zonë?
- Cilat janë projektet që duhet të zhvillohen?
- Cilat janë masat e parapara?
- Cilat janë aktivitetet tjera?
- Cili është grupi i synuar (gjinia, grupmosha, fshat/qytet/zonë urbane e caktuar)?
- Cilat organizata/individë janë përgjegjës për zhvillimet e planifikuara?
- Kur do të kryhen zhvillimet, projektet, aktivitetet dhe ndërmerren masat ?
- Çfarë problemesh mund të ketë me realizimin e planeve ?
- Çfarë masash duhen marrë për të shmangur/zbutur problemet?
- Si do të mbledhen/merren dhe ruhen të dhënat?
- Çfarë aspekte të logjistikës duhet të kemi parasysh?
- Ku do të organizohen aktivitetet?
- Çfarë burimesh njerëzore, financiare dhe materiale duhen?
- Kush do t'i sigurojë këto burime?
- Kush do të kryejë mbikëqyrjen/kontrollin dhe monitorimin? Si do të kryhen?
- Si do të vlerësohen aktivitetet?

Gjersa sa i përket monitorimit, pyetjet vijuese thelbësore duhet të adresohen:

- Si e dimë që kemi arritur aty ku kemi planifikuar?
- Cila ka qenë rruga të cilën e kemi kaluar, problemet dhe përparmit e asaj rrugë drejt zbatimit të asaj që është planifikuar?
- Me çfarë cilësie dhe efikasiteti kemi arritur aty ku kemi planifikuar?

Monitorimi shërben si udhërrëfyes, duke i përgjigjur pyetjet vijuese:

- Deri në çfarë shkalle janë realizuar zhvillimet, projektet dhe masat e aktivitetet e planifikuara?
- A po bëjmë progres për arritjen e tyre ?
- Çfarë jemi duke bërë?
- Si jemi duke punuar?
- Pse po veprojmë në këtë mënyrë?

Edhe më thellë për interesa të veçanta të planeve mundet të përgjigjemi në pyetjet se:

- Çfarë zhvillime, masa, shërbime/projekte janë ofruar, kujt u janë ofruar, kur janë ofruar, për sa kohë, dhe në çfarë konteksti?
- Si ka qenë cilësia e zhvillimeve, masave, shërbimeve/projekteve të ofruara?
- Sa është kostoja për njësi të zhvillimeve, masave, projekteve/shërbimeve?

Monitorimi, kryhet në intervale kohe të ndryshme: mujore, dy mujore, tre mujore por për qëllime të këtij udhëzuesi më i rëndësishmi është ai gjashtë mujore dhe vjetore por edhe për disa vite radhazi pasi që këto plane janë disa vjeçare, intervalet kohore caktohen varësisht edhe nga zhvillimet brenda drejtorive por edhe asaj që është paraparë me plan zbatimit, një raport monitorimi përgatitet nga Ekipi komunal për përkrahje të zbatimit të planeve, Monitorim dhe Vlerësim edhe atë në intervale kohore të arsyeshme gjashtë mujore, dhe vjetore.

Monitorimi kërkon informacion në tre faza kryesore:

18. Informatat hyrëse: Në këtë fazë që duhet të sigurojmë informatat nga ajo se çka është planifikuar në secilën fushë që në rastin më të mirë bëhet me plan sektorial të zbatimit të planeve ose edhe me informatat nga korniza e zhvillimit hapësinorë dhe strategjitë për zbatim të planeve e që përfshijnë: zhvillimet, projektet, aktivitetet, masat, stafin, financat, materialet dhe kohën e paraparë. Në informatat hyrëse vlen të ceket treguesit që janë paraparë për zbatim të planeve do të shfrytëzohen edhe për monitorimin e zbatimit.

19. Procesi: Numri i aktiviteteve dhe burimet që do të përdoren (njerëzore dhe financiare), për të arritur rezultatet e pritshme të Hartës Zonale.

20. Informatat dalëse: Progresi në zbatimin e planeve, Rezultatet e arritura nga zbatimi i asaj që quhet informatë hyrëse e cila ka kaluar në fazën e dytë që quhet proces, thjesht progresi, shkalla e realizimi dhe cilësia e realizimit të zhvillimeve, projekteve, aktiviteteve, masave e elementeve tjera në informatat hyrëse. Progresi në zbatim do matet bazuar në treguesit e paraparë për zbatim dhe në tabelat e njëjta por pasi që nga ministria e pushtetit lokal dhe MMPH dhe MBPZHR janë prezantuar disa tregues që masin preformancën, monitorimi i zhvillimeve të planifikuara do të pasqyrohet edhe nëpërmjet këtyre treguesve.

Karakteristikat kryesore të monitorimit janë:

- Është një proces i vazhdueshëm,
- Fillon me planin e zbatimit dhe mbikëqyrë çdo aktivitet deri në përfundim,
- Është dinamik, pasi proceset dhe detajet evoluojnë dhe ndryshojnë gjatë monitorimit,
- Është parashikues pasi synon të parandalojë probleme dhe vështirësi,
- Është vazhdimisht korrigjues sugjeron masa përmirësuese sapo identifikohen probleme,
- Është funksion gjithëpërfshirës pasi çdo institucion, grup apo edhe individ përgjegjës për zbatimin e Hartës Zonale duhet të kryej pjesën e vetë të obligimeve,
- Për zhvillime, projekte, aktivitete dhe masa të interesit përpos ekipit të monitorimit mundë të kryhet nga lart poshtë, dhe nga poshtë lart: nxitet nga iniciativa nga lart dhe me informatat/komentet/sugjerimet nga poshtë,
- Përforon mendimin e qartë dhe siguron vigjilencë të vazhdueshme, pasi që me planin për zbatim janë përcaktuar tregues të qarta dhe të metat ose problemet që vihen re duhen adresuar dhe korrigjuar sa më parë.

Elementet e procesit të monitorimit janë:

21. Caktimi i standardeve të monitorimit

Përcaktohen në fazën e planifikimit të monitorimit: vizioni, qëllimet, objektivat, synimet, zhvillimet, projektet, aktivitetet, masat dhe afatet kohore zërthehen në tregues sasior dhe cilësor të kuptueshëm dhe të pranuar nga të gjithë që janë të përfshirë në zbatimin e Hartës Zonale, ky standard i monitorimit për fillim do ketë për bazë të gjitha ato që konsiderohen të rëndësishme për standardin e Kosovës nga kjo fusha e zbatimit të planeve për monitorim mirëpo ma vonë do shikohen edhe mundësit e një standardi që do caktonte standardin e treguesve sasior dhe cilësor që do shërbenin edhe për matje të preformancve ndërkombëtare pos atyre për interes komunal dhe qendror.

22. Ngritja e një sistemi/mekanizmi/feedbacku/ushqyerje me informacion

Efektiviteti i monitorimit varet nga saktësia dhe besueshmëria e informacionit. Për këtë qëllim duhet ngritur një mekanizëm që siguron mbledhjen e informacionit, statistikave, të dhënave, raporteve etj., që sigurojnë bazën për disponibilitetin e vazhdueshëm të një informacioni të vlefshëm, në bazë të të cilit do ndërtohet. Mekanizmi i feedback- ut/ ushqyerja me informacion mund të jetë me gojë (vizita në terren), ose me shkrim (informatë, formularë raportimi). Ekipi Komunal për Përkrahje të Zbatimit të Planeve, Monitorim dhe Vlerësim do jetë mekanizmi kryesor

në këtë funksion dhe drejtoritë, institucionet, grupet e individët do futen në shërbim për këtë qëllim nga mekanizmi kryesor .

23. Matja dhe vlerësimi i performancës.

Matja e performancës/punës në zbatim të planeve, nuk ka të bëjë vetëm me matjen dhe vlerësimin e performancës të asaj çfarë ka ndodhur në kuptimin e zhvillimeve, masave, projekteve dhe aktiviteteve por parashikon, edhe çfarë do të ndodhë. Kjo do të thotë se devijime, mungesa, mbivendosje, parashikohen me kohë dhe ndërmerren masa korigjuese.

24. Marrja e masave korigjuese

Kur vihen re devijimet nga plani për zbatim në kuptimin e zhvillimeve, masave, projekteve, standardeve/objektivave e caktuara, afateve kohore, kostove financiare duhen marrë masa korigjuese. Kjo do të thotë ndryshim të Hartës Zonale të zbatimit, ndryshim në institucionet dhe në personelin kompetent, mbikëqyrje më e rreptë, vizita më të shpeshta në terren, motivim të pjesëmarrësve dhe grupit të synuar, procedura me të thjeshta financiare etj.

Monitorimi, është funksion që përfshinë institucionet, stafin që merret me zbatimin e planeve edhe të interesuar tjerë siç janë shoqëria civile, OJQ, udhëheqësit e fshatrave dhe të tjerë (hirearkia: vendimmarrja/drejtuesit dhe stafi në terren).

Kushtet për monitorim efektiv:

- Analiza dhe takime të rregullta në interval periodik,
- Vizita në nivele të ndryshme qeveritare dhe vizita në terren të planifikuara dhe surprizë,
- Objektiva të qartë dhe të matshëm,
- Buxhet specifik për monitorim,
- Sistem monitorimi specifik për zhvillime, masa, projekte dhe aktivitete të planifikuara,
- Gjuhë dhe format të thjeshtë,
- Raportim të shpejtë të problemeve (vonesave, dështimeve, shpenzimeve të paparashikuara ose rasteve të suksesshme),
- Masa korigjuese duhen ndërmarrë menjëherë, sapo të identifikohen problemet.

Detyrimet dhe mjetet e monitorimit për monitoruesit, janë:

- Caktimi i stafit nëpër drejtori dhe i mjeteve për mbledhjen e të dhënave, që varion nga drejtorja në drejtori dhe nga zhvillimi, masa, projekti dhe aktiviteti i planifikuar (fillimisht do preferohej që një staf i cili është trajnuar për matjen e performancës së komunës të jetë pjesë e ekipit ose vetë ekipi e monitorimit)
- Treguesit do përdoren të njëjtit sikur të plani i zbatimit mirëpo mundë të përdoren për interesa të veçanta edhe pyetësor për grupin e synuar dhe personelin, të cilët duhet të jenë të kuptueshëm dhe të thjeshtë,
- Lista e kontrollit që përcakton zhvillime, aktivitete, projekte të planifikuara me plan për zbatim dhe afatet kohore por edhe informatat e përgjithshme dhe të veçanta,
- Vëzhgime por nga një herë edhe vizita të planifikuara dhe befasuese në terren nga zhvillimet, projektet dhe masat e planifikuara në fazën e zbatimit,
- Intervista me përfitues, përfaqësues të komunitetit, personelin zbatues, dhe aktore të tjerë,
- Fokus grupe/diskutime me aktorë të ndryshëm,
- Formulare standard për mbledhjen e të dhënave.

Dallimi në mes monitorimit dhe vlerësimit **Monitorimi**

Derisa për monitorim folëm si më lartë dhe konstatuam se :

- Është i vazhdueshëm gjatë zbatimit dhe përfshin aktorët raportues në zbatim që japin informacion sipas një sistemi të mbledhjes së të dhënave,
- Dokumenton progresin në mënyrë të vazhdueshme,
- Fokusohet në hartimin dhe zbatimin operacional të zhvillimeve,masave,aktiviteteve dhe projekteve dhe karakteristikave tjera të monitorimit thjesht përgjigjeje në atë se: Çfarë ndodhi, si dhe pse?

Vlerësimi

Vlerësimi fokusohet në pyetjet themelore të rezistencës të zhvillimeve,masave,aktiviteteve dhe projekteve, duke vlerësuar:

- Arritjen e rezultateve dhe impaktit në afate kohore më të gjata (a, i arritëm objektivat info që nuk e marrim në monitorim),
- Momentet periodike të rëndësishme (në fillim, në mes dhe në fund të zhvillimeve,masave, aktiviteteve dhe projekteve),
- Arritjet (sukseset, dështimet), dokumenton mësim/eksperienca, edhe se bëhet brenda strukturave duhet të jetë pavarur nga stafi i menaxhimit/zbatimit,
- Analize nga jashtë,
- Analizon dhe rekomandon për vendimmarrësit në nivele strategjike/ politik bërjeje.
- Thjeshtë vlerësimi na jep përgjigjeje në pyetjet: Çfarë ndryshimesh realizuam/Çfarë ndryshoi?

Monitorimi dhe vlerësimi janë procese bashkëpunimi nga të cilat mësohet rreth zbatueshmërisë së Hartës Zonale dhe është përgjegjësi e të gjithë ekipit dhe jo vetëm e ekipit zbatues, mbikëqyrës apo vlerësimit,

3. Kuadri logjik jep strukturën e M&V,

4. Metodatat për M&V, duhet të jenë praktike, efektive, transparente dhe të vlefshme (sondazhe, takime me përfitues, diskutime në grup, intervista me aktor kryesor, raste studimore,vëzhgime),

5. Të caktohet buxhet specifik për M&V: diku 1-3% të buxhetit total të të zhvillimeve,masave, aktiviteteve dhe projekteve.

Vlerësim

Vlerësimi, ka origjinën e saj në "Valupure" fjalë latine që do të thotë vlerën e një ideje, gjë e veçantë ose veprim. Vlerësimi kështu, na ndihmon të kuptojmë me vlerë, cilësi, sasi e rëndësisë, shkallë apo kusht të çfarëdo ndërhyrjeje dëshiruar për të trajtuar një problem shoqëror.

Kuptimi i Vlerësimit

Vlerësimi, do të thotë gjetja e vlerës së diçkaje.

Vlerësimi, thjesht i referohet procedurave të faktit gjetur.

Vlerësimi përbëhet nga vlerësimet nëse janë apo jo disa zhvillime, masa, aktiviteteve dhe projekte, trajtimi dhe ndërhyrje janë në përputhje me standardet e pranuar përgjithësisht profesionale.

Çdo informacion i marrë nga çdo anë, në të dyja sjelljes me ose rezultatin e ndërhyrjeve, trajtimit apo të zhvillimeve, masave, aktiviteteve dhe projekteve ndryshimi është konsideruar të jetë vlerësimi.

Vlerësimi është caktuar për të siguruar informacion sistematik, të besueshme dhe të vlefshme mbi sjelljen, ndikimi dhe efektivitetin e zhvillimeve, masave, aktiviteteve dhe projekteve.

Vlerësimi është në thelb studimi dhe shqyrtimi i përvojës operative kaluar.

Qëllimi i vlerësimit

Perspektiva-llogaridhënia

Për të bërë përdorimin më të mirë të mundshëm të burimeve nga ana e menaxherëve të Hartës Zonale të cilët janë përgjegjës për vlerën e programeve të tyre.

Matja e arritjeve në mënyrë që të shmangin dobësitë dhe gabimet në të ardhmen.

Respektimi i efikasitetit të teknikave dhe shkathtësive të punësuar.

Fushëveprimi për modifikimin dhe përmirësimin.

Verifikimi nëse kanë arritur përfitimet njerëzit për të cilët zhvillimi, masa, aktiviteti dhe projekti ishte menduar.

Perspektiva e njohurive.

Qëllimi i vlerësimit, është të krijojë njohuri të reja rreth problemeve sociale dhe efektivitetin e politikave dhe programeve të hartuara për ti lehtësuar ato.

Pjesëmarrja e njerëzve: të kuptuarit dhe arsyet për të njëjtën gjë.

Vlerësimi ndihmon për të bërë plane për punën e ardhshme.

Parimet e vlerësimit

Në vijim janë disa nga parimet, të cilat duhet të mbahen në funksion në vlerësim.

1. Vlerësimi është një proces i vazhdueshëm (vazhdimësi).
2. Vlerësimi duhet të përfshijë koston minimale të mundshme (të lira).
3. Vlerësimi duhet të bëhet pa paragjykim për ditë për punën e përditshme (pengesë minimale në ditë për punën e përditshme).
4. Vlerësimi duhet të bëhet mbi një bazë të bashkë-operativ në të cilin gjithë akterët duhet të marrin pjesë (pjesëmarrja total).
5. Aq sa është e mundur, komuna duhet të vlerësojë vetë planin e saj, por nganjëherë jashtë makinerive të vlerësimit duhet të bëhen gjithashtu përdorimin e jashtëm (vlerësimi i jashtëm).
6. Ekzaminimi i përgjithshëm i komunës do të zbulojë forcën dhe dobësitë. (komuna / plani në tërësi).
7. Rezultati i vlerësimit duhet të ndahen me punëtorët e komunës (ndarja).

Fazat në vlerësim

Vlerësimi bëhet në Fazën fillestare, në fazën e monitorimit të zbatimit të planeve si proces i vazhdueshëm dhe në fazën e përfundimit si vlerësimi përfundimtar.

Hapat në vlerësim

Të mësuarit në lidhje me zhvillimet, masat, aktivitetet dhe projektet në planin e zbatimit, treguesit e Hartës Zonale, dhe vlerësimin e vlerësimit.

Informojnë njerëzit dhe akterët tjerë të shqetësuar për vlerësimin e Hartës Zonale & Treguesit.

Rishikimi dhe përpunimin e Hartës Zonale të vlerësimit.

Inicimi/vlerësimi.

Ndarjen e informative.

Llojet e vlerësimit

Vlerësimet mund të kategorizohen në tituj të ndryshëm:

A) Sipas kohës (se kur do të vlerësojë).

Vlerësimi informativ i bërë gjatë zbatimit-zhvillimit.

Fazat

(Vlerësimi i procesit, të vlerësuarit e zhvillimeve, masave, aktiviteteve dhe projekteve)

Vlerësimi përmbledhës Vlerësimi Rezultatit etj

B) Nga komuna ose institucionet tjera, Kush ka vlerësuar?

Vlerësimi i brendshëm, vlerësimi i jashtëm:

Kjo është një përparim /ndikimi i pa anshëm, objektiv, i detajuar edhe se vlerësimi bëhet nga ekipi komunal në disa raste vlerësimet bëhen edhe nga ministrit e ndryshme.

C) Nga fazat

Në vazhdim e sipër të zhvillimeve, masave, aktiviteteve dhe projekteve.

Gjatë implementimit: Në fund të pas një vonesë kohore një zhvillimi, mase, aktiviteti dhe projekti ose menjëherë nga përfundimi.

Pas përfundimit të një projekti zhvillimi, mase, aktiviteti dhe projekti.

Brendshme/Jashtme

Vlerësimi/Vlerësimi i brendshëm i zbatimit të planeve

Vlerësimi i brendshëm (ose ndryshe monitorimi, vlerësimi në harmoni) është një proces i vazhdueshëm, i cili është bërë në pika të ndryshme dhe në lidhje me aspekte të ndryshme të veprimit të një komune nga stafi komunal, vetë bordi i drejtorëve, kryetari i komunës dhe përfituesit.

Të jashtme/Jashtë. Vlerësimi: (Kjo është bërë nga një trup i jashtëm/kontrolli)

Ky lloj vlerësimi mund të bëhet nga ministritë e ndryshme, donatorët dhe deri te shoqëria civile .

Metodat e vlerësimit

Gjatë viteve, një shumëllojshmëri e metodave janë evoluuar nga akademikët, institucionet dhe profesionistët për vlerësimin e çdo zhvillimi, mase, aktiviteti dhe projekti. Disa prej praktikave të përdorura zakonisht janë dhënë më poshtë.

Informacione të dorës së parë:

Një nga metodat më të thjeshtë dhe më e lehtë e vlerësimit nga marrjen e informacionit të dorës së parë në lidhje me progresin e performancës, etj, problem zonat e një zhvillimi, mase, aktiviteti dhe projekti nga një mori e stafit, ekipi komunal për monitorim dhe vlerësim, të personelit në terren, specialistë të tjerë dhe publiku që lidhen direkt me zhvillimin, masën, aktivitetin dhe projektin. Vëzhgimi i drejtpërdrejtë dhe dëgjimi në lidhje me ecurinë dhe grackave të lehtësuara më tej shanset e një vlerësimi efektiv.

Raportet formale / Informale periodike:

Vlerësimi bëhet edhe përmes raporteve formale dhe joformale.

Statusi i Projektit- Raportit:

Nga kjo, mund të kuptojmë gjendjen e tanishme: performancën, orarin, koston dhe të mbajë ups, shmangie nga orari origjinal.

Orari:

Kjo tregon orarin kohor për zbatimin e zhvillimit, masës, aktivitetit dhe projektit. Nga kjo mund të kuptojmë ndonjë vonesë, kostoja e vonesës dhe humbjen përfundimtare.

Zhvillimi, Masa, aktiviteti dhe projekti, Statusi Financiar, Raporti:

Mund të keni një vështrim në një shikim, nëse zhvillimi, mase, aktiviteti dhe projekti është duke u implementuar në kuadër të buxhetit realistë dhe me kohë.

Raportet informale:

Raportet jozyrtare të tilla si letra anonime, raportet, ankesat për shtyp nga përfituesit & peticionet ndonjëherë zbulojnë natyrën e vërtetë të zhvillimit, masës, aktivitetit dhe projektit, edhe pse këto raporte janë të njëanshëm.

Prezantime grafike:

Prezantime grafike përmes ekranit të Listës: grafikët, fotografitë, ilustrimet etj. Në zyrën e zhvillimit, masës, aktivitetit dhe projektit është edhe një instrument për një vlerësim të ngushtë.

Qëndrimi Komisionet shqyrtimi i vlerësimit:

Disa nga organizatat, kanë komitete të përbërë nga një mori ekspertësh dhe specialistë të cilët i plotësojnë rregullisht në intervale të shpeshta për të diskutuar për problemet dhe për të sugjeruar masa përmirësuese.

Profilat e zhvillimit, masës, aktivitetit dhe projektit

Përgatitja e profileve të zhvillimit, masës, aktivitetit dhe projektit nga ekipi i autorizuar mbi bazën e udhëzimeve të standardizuara dhe modele të zhvilluara për këtë qëllim, është edhe një tjetër metodë e vlerësimit.

Shikime rreth vlerësimit

Vlerësimi perceptohet kryesisht nga tre këndvështrime.

Vlerësimi si një analizë – përcaktimin, meritat apo mangësitë e një zhvillimit, masës, aktivitetit dhe projektit, metodat dhe procesin.

Vlerësimi si një hetim sistematik dhe i vazhdueshëm për të matur efikasitetin e mjeteve, për të arritur skajet e tyre të veçanta formuar.

Në kontekstin e Komunës

Vlerësimi i administratës, nënkupton vlerësimin ose gjykimin e vlerës së dhe efektivitetit të gjitha proceset (p.sh. Planifikimi, organizimi, stafi etj.) projektuar për të siguruar që komuna, do të zbatojë planet.

Fushat e vlerësimit

Vlerësimi mund të ndahet në aspekte të ndryshme, në mënyrë që çdo drejtori e komunës, ose e zhvillimit, mase, aktiviteti dhe projekti të veçantë, është vlerësuar. Këto, mund të jetë.

Qëllimi

Rishikimi objektivat e komunës dhe,sa larg këto janë duke u përmbushur.

Programi.

Aspekte të tilla si numri i përfituesve, natyra e shërbimeve kryera ndaj tyre, reagimi i tyre për efektivitetin e shërbimeve, dhe përshtatshmërinë e shërbimeve etj mund të vlerësohet.

Stafi

Suksesi i çdo zbatimi të Hartës Zonale, varet nga lloji i personelit të punësuar në komunë. Qëndrimi i tyre, kualifikimet, politika rekrutimi, përfitimet pagave dhe të tjera dhe mjedisit organizativ. Këto janë fushat të cilat ndihmojnë për të kuptuar efektivitetin e zhvillimit, masës, aktivitetit dhe projektit.

Administrata financiare

Fluksi i të hyrave për zbatim plani dhe i shpenzimit të tyre, janë një faktor vendimtar në çdo komunë. Për investimet e çdo zhvillimi, mase, aktiviteti dhe projekti duhet ditur: shpenzimet a janë bërë mirë, janë përvetësuar, janë shpërdoruar...?

Këto janë disa prej treguesve që tregojnë arsyet për suksesin apo dështimet e çdo zhvillimi, mase, aktiviteti dhe projekti.

Kemi dy lloje kryesore të Monitorimit dhe Vlerësimit (M&V)

(M&V) me Observim (Vëzhgim).

(M&V) me Pjesëmarrje.

Monitorimi dhe vlerësimi me pjesëmarrje (M & V)

Është përpjekje e përbashkët ose Partneriteti i dy ose më shumë palëve të interesuara për të monitoruar dhe vlerësuar, në mënyrë sistematike, një ose më shumë zhvillime dhe aktivitete nga zbatimi ose mos zbatimi i planeve që në rastin e komunave partnere dhe tjerave në Kosovë raportet përfundimtare të vlerësimit dhe monitorimit do jenë nga komuna dhe qeveria qendrore dhe të tjerë.

Në përgjithësi, qëllimi imonitorimitdhevlerësimitmund të jetë:

Për të vlerësuar rezultatet e Hartës Zonale,

Për të përmirësuar procesin e menaxhimit dhe të planifikimit,

Për të nxitur të mësuarit,

Për të kuptuar perspektivat eaktorëve të ndryshëm,

Për të siguruar përgjegjshmërinë.

Monitorimi dhe vlerësimi duhet të krijojëpikareferimi

Zhvillimet dhe Aktivitetet e planifikuara	Monitorimi
Çka është zbatuar :	
Rezultatet:	Vlerësimi
Ndikimi:	
Konstatime dhe hulumtime:	

Tregusit për monitorim dhe vlerësim

Fusha tematike e infrastrukturës				
Drejtoria e Infrastrukturës				
Planifikuar	Treguesi		Monitorimi	Vlerësimi
Rrugë lokale - asfaltim (a-b)	Gjatësia (M)	1800 m	Info e përgjithshme Info e veçantë	Info e përgjithshme Info e veçantë
Kanalizim	Gjatësia (M)	4800 m		
Deponi të përkohëshme	Sasia me cope (2)	Sipërfaqja me ari (44)		

Harta Zonale e Komunësparasheh zhvillimin strategjik hapësinor i cili duhet të monitorohet për secilin vit radhazi. Mirëpo për shkak se plani i veprimit i HZK-së përmban vetëm projektet kryesore strategjike, raporti monitorues vjetor duhet të bazohet në planin e veprimit për zbatim të

Hartës Zonale të Komunës, i cili duhet të bazohet në planin e veprimit të HZK-së, i zgjeruar për veprimet që duhet ndërmarrë dhe afatet kohore.

Kështu që monitoruar zbatimin e Hartës Zonale të Komunës, i cili bazohet në planin e veprimit të HZK-së, Komuna njëkohësisht do të përmbushë edhe detyrimin ligjor për monitorimin e HZK-së.

Plani i veprimit i HZK-së përmban informatat e nevojshme për monitorim, sic janë:

25. Burimi/ burimet e të dhënave;
26. Frekuenca e mbledhjes së të dhënave;
27. Të dhënat bazë;
28. Qëllimet dhe kornizat kohore për arritjen e qëllimeve;
29. Institucioni/ institucionet përgjegjës për mbledhjen e të dhënave.
30. Gjersa, sa i përket sistemit të përdorur për menaxhimin e të dhënave, Udhëzimi Administrativ për Bazën e të Dhënave përcakton mëyrën si këto të menaxhohen.
31. Kuvendi Komunal në baza vjetore shqyrton Raportin monitorues të zbatimit të qëllimeve dhe të objektivave të deklaruara në Hartën Zonale e Komunës dhe Hartën Zonale të Komunës, si dhe Planet Rregulluese të Hollësishme të përgatitur nga Drejtoratet sektoriale të Komunës.
32. Përderisa drejtoritë sektoriale janë përgjegjëse për monitorimin dhe përgatitjen e raporteve monitoruese sipas përcaktimit në planit të veprimit për zbatim, drejtoria e cila është përgjegjëse për urbanizëm dhe planifikim hapësinor është përgjegjëse për përgatitjen raportit monitorues, i cili duhet të shqyrtohet nga Kuvendi Komunal.

▪ Elementet dhe udhëzimet për hulumtim të mëtutjeshëm

Harta Zonale e Komunës ofron kornizë punuese për studime të mëtutjeshme në zhvillimin e komunës, që lehtëson zbatimin e Planit. Në vazhdim janë dhënë temat e studimit të nevojshëm në mënyrë që të vazhdohet me zbatimin e planit:

- Hulumtime në funksion të kompletimit të kadastrit për zonat që janë nën masa komasacioni
- Hulumtime në funksion të kompletimit të kadastrit nëntokësor;
- Hulumtime në funksion të kompletimit të kadastrit të ndotësve të ajrit;
- Thellim i hulumtimeve për zonat tokësore të ndotura dhe ndotësit tjerë;
- Thellim i hulumtimeve për rregullim të regjimit të Ujrave;
- Thellim i hulumtimeve për inventarizim të llojeve organike;
- Thellim i hulumtimeve për zonat me pasuri nëntokësore;
- Thellim i hulumtimeve në saktësimin e hartës së bonitetit të tokës;
- Studimi i pasurive nëntokësore;
- Hulumtime në Plan-konceptin për zhvillimin e turizmit;
- Hulumtime në Plan të Lëvizshmërisë dhe të trafikut;
- Hulumtime në Plan-koncept të zhvillimit ekonomik;
- Vlerësim për prodhim të energjisë alternative duke përfshirë studimin e arsyeshëmëris përzhvillimet në shkallë të vogël të biomasës, solar dhe energji tjera ripërtëritëse.

Plani i monitorimit

Prioritetet strategjike për zhvillimin e ekonomik								
PS - ZhE 1 Zhvillimi i zonës ekonomike								
	Aktivitetet e parapara	Përfshirja e aktivitetit në KAB	Përfshirja e aktivitetit në BVK	Treguesit e monitorimit të zbatimit të aktivitetit	Shkalla e zbatimit të aktivitetit të planifikuar	Treguesi cilësor i zbatimit të aktivitetit	Vlerësimet mbi zbatimin e projektit	Përgjegjëse për monitorim të zbatimit
1	Investime në zonën ekonomike në Optrush	Po/Jo	Po/Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përshkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	DE
2	Ndërtimi dhe rregullimi infrastrukturës së oborrit (depot e Matreksit)	Po/Jo	Po/Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përshkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	DSHP
3	Ndërtimi, restaurimi, meremetimi i Shtëpisë së Verës	Po/Jo	Po/Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përshkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	DE
4	Krijimi i hapësirave për biznese në Ratkoc	Po/Jo	Po/Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përshkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	
5	Krijimi i hapësirave për biznese në Krushë e Madhe	Po/Jo	Po/Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përshkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	

6	Krijimi i hapësirave për biznese në Çifllak	Po/Jo	Po/Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përshkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	
PS - ZhE 2 Promovimi i investimeve								
1	Ndërtimi i bujtinave në vendet me potencial turistik	Po/Jo	Po/Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përshkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	DE
2	Tregu i gjelbërt ditor	Po/Jo	Po/Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përshkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	DE
3	Ndërtimi i lokaleve afariste zejtare	Po/Jo	Po/Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përshkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	DE
4	Hartimi i projekteve të ndryshme	Po/Jo	Po/Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përshkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	DUPMM
PS - ZhE 3 Përmirësimi i efijencës me energji								
1	Energji termike (ngrohja e qytetit) EK	Po/Jo	Po/Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përshkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	

2	Mullinjtë e erës (turbinë me erë) për prodhimin e energjisë	Po/Jo	Po/Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përshkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	
3	Eficienca e Energjisë	Po/Jo	Po/Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përshkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	
4	Energji e gjelbërt	Po/Jo	Po/Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përshkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	
Prioritetet strategjike për përmirësimin e mirëqenies sociale								
PS - MS1 - Zhvillimi i aftësive për punësim me fokusim te femrat dhe të rinjtë.								
	Aktivitetet e parapara	Përfshirja e aktivitetit në KAB	Përfshirja e aktivitetit në BVK	Treguesit e monitorimit të zbatimit të aktivitetit	Shkalla e zbatimit të aktivitetit të planifikuar	Treguesi i cilësisë së zbatimit të aktivitetit	Vlerësimet mbi zbatimin e projektit	Përgjegjëse për monitorim të zbatimit
1	Përfshirja e profileve teknike në kurrikulën e shkollës së mesme profesionale.	Po/Jo	Po/Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përshkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	DKA
2	Përfshirja e profileve të bujqësisë në kurrikulën e shkollës së mesme profesionale.	Po/Jo	Po/Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përshkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	DKA

3	Organizimi i trajnimeve profesionale sipas nevojave në tregun e punës.	Po/Jo	Po/Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përshkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	QPS
PS – MS2 - Zhvillimi i programeve për punësim.								
1	Programet/aktivitetet për punësim sezonal: - pastrimi i lumenjve, hapësirave publike dhe parqeve.	Po/Jo	Po/Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përshkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	QPS
PS – MS3 - Sigurimi i punës sezonale.								
	Aktivitetet e parapara	Përfshirja e aktivitetit në KAB	Përfshirja e aktivitetit në BVK	Treguesit e monitorimit të zbatimit të aktivitetit	Shkalla e zbatimit të aktivitetit të planifikuar	Treguesi i cilësisë së zbatimit të aktivitetit	Vlerësimet mbi zbatimin e projektit	Përgjegjëse për monitorim të zbatimit
1	Krijimi i fondit për përkrahje financiare të kategorive në nevojë.	Po/Jo	Po/Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përshkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	Kuvendi; dhe Zyra e Kryetarit
2	Rritja e nr. të bursave për nxënësit në nevojë dhe studentët.	Po/Jo	Po/Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përshkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	DKA
3	Projekte me bashkëfinancim për rastet sociale.	Po/Jo	Po/Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përshkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	Kuvendi; dhe Zyra e Kryetarit

4	Përkrahja e OJQ-ve dhe çështje sociale.	Po/Jo	Po/Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përshkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	Zyra e kryetarit; dhe DSHMS
Prioritetet strategjike për përmirësimin e nivelit të shërbimeve shëndetësore								
PS – SHSH1 Përmirësimi i infrastrukturës fizike në shërbimet shëndetësore.								
	Aktivitetet e parapara	Përfshirja e aktivitetit në KAB	Përfshirja e aktivitetit në BVK	Treguesit e monitorimit të zbatimit të aktivitetit	Shkalla e zbatimit të aktivitetit të planifikuar	Treguesi së cilësisë të zbatimit të aktivitetit	Vlerësimet mbi zbatimin e projektit	Përgjegjëse për monitorim të zbatimit
1	Blerja e Veturave dhe Autoambulancave.	Po/Jo	Po/Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përshkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	DSH
2	Sigurimi i objekteve shëndetësore nga fatkeqësitë natyrore.	Po/Jo	Po/Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përshkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	DSHMS
PS – SHSH2 - Përmirësimi i infrastrukturës teknike në objektet shëndetësore.								
1	Dezinsektimi, Dezinsektim dhe Derrratizim.	Po/Jo	Po/Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përshkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	DSHMS
Prioritetet strategjike për përmirësimin e nivelit të arsimit								
PS – NA1 - : Investime në përmirësimin e kushteve infrastrukturore të shkollave në funksion të rritjes së cilësisë në arsim dhe ndërtimin e shkollave të reja.								

	Aktivitetet e parapara	Përfshirja e aktivitetit në KAB	Përfshirja e aktivitetit në BVK	Treguesit e monitorimit të zbatimit të aktivitetit	Shkalla e zbatimit të aktivitetit të planifikuar	Treguesi i cilësisë së zbatimit të aktivitetit	Vlerësimet mbi zbatimin e projektit	Përgjegjëse për monitorim të zbatimit
1	Ngrohje qendrore për shkollat e komunës së Rahovecit - vazhdim	Po/Jo	Po/Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përshkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	DKA
2	Riparime në shkolla	Po/Jo	Po/Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përshkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	DKA
3	Drenazhimi dhe hidroizolimi i objekteve shkollore.	Po/Jo	Po/Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përshkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	DKA
